



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.06.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar.

2. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar.

3 . Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Elena Xhina, Alket Hyseni, Spartak Braho, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Ediola Braha, Alban Zeneli, Xhemal Qefalia, Edlira Bode dhe Ralf Gjoni.

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Damian Gjikhuri, Bashkim Fino, Edmond Leka, Jurgis Çyrbja, Andi Përmeti, Elda Hoti dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Elvis Koci - Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë për Parandalimin e Pastrimit të Parave

Agim Muslia - Drejtor i Drejtorisë për Parandalimin e Pastrimit të Parave

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi është i plotë për të vijuar me rendin e ditës.

Si pikë e parë e rendit të ditës kemi shqyrtimin nen për nen të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 157 të vitit 2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit” të ndryshuar””.

Pikën e dytë të rendit të ditës po e prezantoj që tani, meqenëse janë dy projektligje pjesë të një pakete prej tri projektligjesh të paketës *MONEYVAL* shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe terrorizmit”, i ndryshuar”.

Komisioni ynë është komisioni përgjegjës, relator për të dyja projektligjet do të jetë kolegu Alket Hyseni. Dje kemi kaluar nen për nen dhe në tërësi njërin nga tri projektligjet e kësaj pakete dhe sot do të vazhdojmë me miratimin e dy të tjerave.

Zoti Hyseni, me cilin jeni gati që të fillojmë?

Alket Hyseni – Me projektligjin “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe terrorizmit”.

Ulsi Manja – Pra, do të vijojmë me projektligjin që është pikë e dytë e rendit të ditës.

A kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga ministria e Financave? Nuk e di a do t’i bashkohet komisionit zëvendësministri, zoti Haxhi?

Elvis Koçi – Unë jam Elvis Koçi, drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave. Besoj se zoti Haxhi është duke ardhur. Kërkoj ndjesë për vonesën e tij!

Ulsi Manja – Nuk ka problem.

Elvis Koçi – Gjithsesi unë jam i gatshëm të vazhdoj.

Ulsi Manja – Ndoshta më vonë zëvendësministri i Financave do t’i bashkohet komisionit, por ne do të vazhdojmë me shqyrtimin nen për nen të këtij projektligji. Nga ministria e Financave kemi zotin Koçi.

Atëherë, zoti Hyseni le të vazhdojmë me projektligjin!

Për efekt të kohës, do të sugjeroja që nëse sugjerimet e pranuar nga komisionet për dhënie mendimi janë pranuar nga relatori për të qenë pjesë e neneve të caktuara, nuk besoj se do të jetë nevoja t’i lexojmë, sepse kolegët e kanë tabelën e integruar të projektligjit mbi tavolinë.

Ndërkohë vijojmë me shqyrtimin dhe miratimin nen për nen, duke filluar me nenin 1.

Fjala për ju, zoti Hyseni.

Alket Hyseni - Faleminderit!

Neni 1 ka një propozim nga Komisioni i Ekonomisë dhe Financave që duhet pranuar. E keni në tabelë, kolona nr. 3. Bëj me dije të gjithë kolegët që tabela ka të përcaktuar 4 kolona, ka ligjin ekzistues, draftin që ka ardhur, përmbajtjen e draftit sipas diskutimeve dhe rekomandimeve të Komisionit të Ekonomisë. Kështu që do t'ju ftoja të më dëgjonit më vëmendje për shkak të volumit të madh.

Propozimet e Komisionit të Ekonomisë duhen pranuar në të gjitha pikat e përcaktuara në këtë nen. Disa janë thjesht teknike legjislativë, pra shqipërimi i ca termave të huaj, disa të tjera janë koncepte dhe propozime, që janë gjykuar si të rëndësishme për t'u pranuar.

Ulsi Manja – Ka ndonjë gjë për nenin 1?

Nuk ka.

E hedhim në votim.

Kush është dakord me nenin 1 sipas variantit të relatorit, duke pranuar edhe një pjesë të propozimeve nga Komisioni i Ekonomisë?

1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 2.

Alket Hyseni – Neni 2 i projektit ndryshon neni 3. Shihni kolonën e tretë ku është drafti i paraqitur nga grupi i punës, të cilës i bëhen disa ndryshime nga Komisioni i Ekonomisë, që do të inkorporohen në formulimin që kishim bërë, me një ndryshim të vogël në germën “gj”, ku, pas fjalisë “ose kryhen transaksione”, të shtohet “ose shërbime”.

Ulsi Manja – Pra edhe për nenin 2, që ndryshon nenin 3 është pranuar një sugjerim nga Komisioni i Ekonomisë dhe Financave.

Kush ka gjë për të komentuar për nenin 2?

Po, zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Në këtë kategori përfshihen edhe individë, të cilët kanë pasur ose kanë funksione të rëndësishme në organizatat ndërkombëtare, përsbi anëtarë të familjes apo personave të lidhur në marrëdhënie të ngushta pune apo biznesi.

Ulsi Manja – E hedhim në votim nenin 2.

Kush është pro?

Kundër? 1 kundër. Abstenim. Nuk ka.

Miratohet neni 2.

Kalojmë te neni 3.

Alket Hyseni – Neni 3, sipas draftit të grupit të punës, nuk ka asnjë ndryshim.

Ulsi Manja – Pas nenit 3 shtohet neni 3/1 me detyrimet e organizimeve ligjore.

Sugjerime nga kolegët nuk shoh se ka.

Kush është dakord me nenin 3? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 4

Alket Hyseni – Për neni 4 ka një sugjerim nga Komisioni i Ekonomisë në pikën 2. Sipas Komisionit të Ekonomisë vlerësohet si e panevojshme pasi shprehja që propozohet të hiqet e qartëson më tepër nenin. Qëllimi i këtij paragrafi lidhet me faktin se pavarësisht se mund të kemi një transaksion me vlerë më të ulët se 100 mijë lekë nga subjektet e këtij ligji, të merren masat e vigjilencës kur ka dyshime të pastrimit të parave.

Ulsi Manja – Dakord me nenin 4? A ka sugjerime? Nuk ka.

E hedhim në votim.

Kush është dakord? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 5.

Alket Hyseni – Neni 5 është drafti i paraqitur nga grupi i punës me një rekomandim të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave në pikën 1 germa “c”, nënndarja 3/i: “Termi “në mënyrë efektive” zëvendësohet me termin “në mënyrë efektive në përputhje me procedurat e përcaktuar në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij”. Sugjerimi i grupit të punës është që ta pranojmë rekomandimin e Komisionit të Ekonomisë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Kush është dakord me nenin 5 sipas variantit që propozohet?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 6.

Alket Hyseni – Neni 6 është draft i grupit të punës me rekomandim të Komisionit të Ekonomisë, por ndryshe nga ky rekomandim, grupi i punës vlerëson se në pikën 6 riformulimi “ndalohet kryerja e vigjilencës të thjeshtësuar ndaj kategorive të klientëve, kur kjo vendoset nga autoriteti përgjegjës” duhet të mbyllet këtu. Komisioni i Ekonomisë propozon edhe shtesën sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara nga ana ligjore në zbatim të këtij ligji, sepse kuptimi i fjalisë është i qartë deri në pjesën nga autoriteti përgjegjës.

Ulsi Manja – Pra ju propozoni të ngelet pika 6 siç është në....

Alket Hyseni – Ka një ndryshim të vogël, por vetëm pjesa e parë e fjalisë do të riformulohet.

Ulsi Manja – Po zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Nuk e di përse e përdorni kaq shpesh fjalën “vigjilencë”, të gjendet një fjalë tjetër.

Ulsi Manja – Po zoti Koçi.

Elvis Koçi – Ne në ligjin aktual kemi termat “vigjilencë e duhur” dhe “vigjilencë e zgjeruar”. Në këtë nen po fusim termin “vigjilenca e thjeshtuar” dhe po ruajmë të njëjtën terminologji që ka ligji ekzistues. Pra, ky term ka shumë vite që përdoret nga subjektet e këtij ligji dhe është i qartë se çfarë nënkupton. Ne po fusim termin “vigjilencë e thjeshtuar”, sepse mendojmë të ruajmë këtë fjalë.

Ulsi Manja – Meqenëse kjo paketë është sugjeruar nga MONEYVAL-i dhe ne jemi në kuadrin e përafrimit, ky term a është i saktë?

Elvis Koçi – Po, shqipërimi është i saktë.

Ulsi Manja – Këtë mund të thuash.

Elvis Koçi – Koncepti që po fusim...

Ulsi Manja – Ne nuk po bëjmë shpikje, sepse e kemi prezantuar si paketa e MONEYVAL-it që ditën e parë që ka ardhur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, a është i njëjti term që përdoret në direktiva?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vigjilenca është kur antenat i ke të ngritura.

Elvis Koçi – Është në përputhje me rekomandimin për t’u bazuar në aktivitetet që zhvillohen.

Ulsi Manja – A jeni dakord me nenin 6?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Alimadhi, nëse keni një term konkret, mund ta propozoni.

Adriatik Alimadhi – Zoti kryetar, me sa e kuptova përfaqësuesin e Ministrisë së Ekonomisë, ai iu referua vazhdimësisë. Unë mendoj se termi “vigjilencë” ju ka shoqëruar historikisht.

Ulsi Manja – Po, është e vërtetë.

Adriatik Alimadhi – Nëse keni ndryshuar nga Partia e Punës te Partia Socialiste, hiqeni edhe atë si fjalë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Koçi, ju lutem, jepni një koment të fundit përpara se ta hedhim në votim.

Elvis Koçi – Standardi i termit është “vigjilenca e duhur”, ne po fusim termin “vigjilencë e thjeshtuar” për rastet kur ka risk të ulur.

Në pikën 6 ne propozojmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë kam merakun se aty ku ne mendojmë se subjekti e trajton me risk të ulët dhe do ta fusë në kanalën e vigjilencës së thjeshtuar, Autoriteti ka të drejtë të ndërhyjë dhe të thotë: “Jo nuk duhet ta kalosh aty, por duhet të vazhdoni të bëni vigjilencën e duhur ose atë standarde”

Ulsi Manja – Zoti Koçi, a ka ndonjë term tjetër për fjalën “vigjilencë”?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti si ekspert thua jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Adriatik Alimadhi – Edhe Balli Kombëtar për një periudhë kishte shumë vigjilentë ndaj atdheut.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 6 me propozimin e bërë nga relatori? Kundër? 3 vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Fjalën e ka zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Zoti kryetar, e kam konkretisht me ju. Nëse ju e shikoni si detyrim këtë matje me numër votash, unë e shikoj si problem. Pra, nëse nuk futet logjika dhe mendimi është problem. Nëse na thoni pushoni me vota, kjo është gjë tjetër. Këtë fjali me termin “vigjilencë” e shikoj si të ngarkuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Po, zoti Muslia.

Agim Muslia – Ky është një term i përshtatur që në fillesat e ligjit të vitit 2001, i cili është ligji i parë për pastrimin e parave dhe ne kemi menduar që të ruajmë në vazhdimësi.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Kalojmë te neni 7.

Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Për nenin 7, i cili ndryshon nenin 5, ka një kërkesë nga Komisioni i Ekonomisë për ndryshim të shkronjës “dh” të pikës 1, e cila riformulohet sipas propozimit, ndërsa pjesa tjerë nuk ndryshon. Ne jemi dakord.

Ulsi Manja – Pra, rekomandimi nga Komisioni i Ekonomisë për germën “dh” merret në konsideratë nga ju. Kush është pro nenit 7? Kundër? 3 vota. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 8.

Alket Hyseni – Neni 8, i cili ndryshon nenin 6, është sipas draftit të grupit të punës pa asnjë ndryshim.

Ulsi Manja – Pra, nuk ka propozime për nenin 8.

Kush është pro për nenin 8, sipas draftit? Kundër? 3 vota. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9.

Alket Hyseni – Për nenin 9 nga Komisioni i Ekonomisë ka propozime për dy ndryshime. Në shkronjën “b” të pikës 1, të përdoret termi “pa vonesë” në funksion të qartësisë dhe zbatimit të këtij detyrimi nga subjektet e ligjit.

Nga Komisioni i Ekonomisë vlerësohet e nevojshme të përcaktohet afati kohor konkret. Në këtë rast fjala “pa vonesë” të zëvendësohet me shprehjen “menjëherë”. Ky propozim pranohet, sepse jemi në përputhje me aktet ndërkombëtare dhe është e zbatueshme në terren.

Ulsi Manja – Pra te neni 9 pranohet vetëm një sugjerim për germën “b”...

Alket Hyseni – Edhe pika 4 riformulohet me atë përmbajtje që është aty.

Ulsi Manja – Po, zoti Muslia.

Agim Muslia – Ne themi që pika 4 të riformulohet me këtë përmbajtje: “Ndalohet mbështetja në palë të treta për rastet e parashikuara në këtë ligj”.

Ulsi Manja – Në variantin e projektligjit është “ndalohet mbështetja...”

Agim Muslia – Është lapsus.

Ulsi Manja – Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Është lapsus, pra bëhet fjalë për rastet e parashikuara si koncept.

Ulsi Manja – Pra, edhe në variantin e draftit e keni “të paparashikuara”, edhe në sugjerim e keni “të parashikuara” dhe sugjerohet të bëhet “të parashikuara”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është pak, sepse deformon komplet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prandaj vijnë në Komisionin e Ligjeve, se do të kishte ngelur te Komisioni i Ekonomisë.

Kush është dakord me sugjerimin e pranuar për germën “b” dhe për pikën 4 të këtij neni? Kundër? 3 vota. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 10.

Alket Hyseni – Për nenin 10, i cili bën ndryshime në nenin 7, do t'i referohemi variantit të grupit të punës pa asnjë ndryshim nga Komisioni i Ekonomisë.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 10, sipas variantit në projektligj? Kundër? 3 vota. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 11.

Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Kemi një propozim nga Komisioni i Ekonomisë. Në pikën 7, fjalët “vëmendje e veçantë” do të zëvendësohen me fjalët “vigjilencë e zgjeruar”, pjesa tjetër është sipas hartimit të draftit të grupit të punës.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 11 me sugjerimin e Komisionit të Ekonomisë për pikën 7? Kundër? 3 vota. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 12.

Alket Hyseni – Për nenin 12, i cili ndryshon nenin 9, ka vetëm një rekomandim nga Komisioni i Ekonomisë, e cila do të pranohet. Pra, pika 5 ndryshohet me këtë përmbajtje dhe teksti është në kolonën e fundit. Pra, rekomandimi nga Komisioni i Ekonomisë pranohet për shkronjën “e”, e cila ndryshohet si më poshtë.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 12, me sugjerimin e pranuar për pikën 5? Kundër? 3 vota. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 13.

Alket Hyseni – Neni 13, i cili ndryshon nenin 10 të ligjit ekzistues, nuk ka asnjë ndryshim nga varianti i grupit të punës.

Ulsi Manja – Hedhim në votim nenin 13. Kush është dakord me nenin 13, sipas variantit të grupit të punës? Kundër? 3 vota. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14.

Alket Hyseni – Për nenin 14 ka një sugjerim nga Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, e cila sugjeron që ky nen të hiqet, pasi përmbajtja e kësaj dispozite është ezauruar në parashikimet e projektligjit, që do të shqyrtojmë më vonë për masat kundër financimit të terrorizmit. Ky propozim pranohet nga grupi i punës.

Ulsi Manja – Pra, neni 14 propozohet që të hiqet nga teksti i projektligjit. Kush është dakord për heqjen e nenit 14 nga teksti i projektligjit? Kundër? 3 vota. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet. Pra, neni 14 hiqet nga teksti i projektligjit.

Neni 15.

Alket Hyseni – Për nenin 15, i cili ndryshon nenin 11, ka dy rekomandime për ndryshime nga Komisioni i Ekonomisë. Në pikën 2 kërkohet një ndryshim dhe në pikën 3 kërkohet të bëhet një riformulim me përmbajtjen që keni në kolonë. Ne jemi dakord që të pranohen të dyja rekomandimet për nenin 15, sipas draftit të grupit të punës.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 15, duke pranuar dy propozime nga Komisioni i Ekonomisë dhe pjesa tjetër ngelet sipas variantit të grupit të punës? Kundër? 3 vota. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 16.

Alket Hyseni – Nenin 16, i cili ndryshon nenin 12 të ligjit aktual, nuk ka asnjë ndryshim nga Komisioni i Ekonomisë, pra është sipas variantit të grupit të punës.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 16, sipas draftit? Kundër? 3 vota. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 17.

Alket Hyseni – Neni 17, i cili ndryshon nenin 14, është sipas variantit të grupit të punës pa asnjë ndryshim.

Ulsi Manja – Pra, neni 17 nuk ka asnjë ndryshim. Kush është dakord? Kundër? 3 vota. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 18.

Alket Hyseni – Për nenin 18 ka një sugjerim nga Komisioni i Ekonomisë, i cili do të pranohet, por jo në masën e afatit, sepse afati do të jetë 5 vjet.

A ka ndonjë sugjerim nga Autoriteti për këtë rast?

Ulsi Manja – Po, përfaqësuesi i Autoritetit.

Agim Muslia – Ne jemi dakord me sugjerimin, pra të mbetet me formatin e ligjit bazë, që është 5 vjet, dhe me kërkesë të autoritetit përgjegjës ky afat mund të shtyhet edhe më tej se 5 vjet.

Ulsi Manja – Po zoti Koçi.

Elvis Koçi – Kriteret ndërkombëtare kërkojnë të paktën 5 vjet, pra mbi 5 vjet. Ne propozuam ta bënim 10 vjet, por me korrigjimin e bërë që kur Autoriteti e kërkon të ruhet më gjatë afati, mund të shtyhet, ne jemi dakord.

Alket Hyseni – Pra, pranohet propozimi për afatin 5-vjeçar, me të drejtën e Autoritetit për të kërkuar një afat më të gjatë se kaq dhe ne jemi në përputhje me standardin ndërkombëtar.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 18, sipas variantit të relatorit të dakordësuar me Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave? Kundër? 3 vota. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 19.

Alket Hyseni – Neni 19, i cili ndryshon nenin 17, është sipas draftit të grupit të punës pa asnjë ndryshim.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Për nenin 19.

Po, zoti Shameti.

Alket Hyseni – Zoti Shameti, ju duhet të jeni i interesuar, sepse hyni te njerëzit me vigjilencë të zgjeruar.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 19, sipas variantit të propozuar nga relatori? Kundër? 3 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 19.

Kalojmë te neni 20.

Alket Hyseni – Për nenin 20, që ndryshon nenin 17, duke shtuar një dispozitë të re, nenin 17/1 “Deklarimet në kufi”, do të pranohet rekomandimi i Komisionit të Ekonomisë për riformulim neni. Për sa i takon pjesës së penalteteve, Autoriteti ka një formulim të vetin, që unë do të doja ta propozonte.

Ulsi Manja – Zoti Koçi, kush e dëshiron fjalën nga ju?

Elvis Koçi – Kundërvajtja për mosdeklarimet për herë të parë propozojmë të gjobitet në masë fikse 20 mijë lekë, sipas germës “a”, 40 mijë lekë, sipas germës “b” dhe 60 mijë lekë, sipas germës “c”, që të mos kemi probleme me interpretimin në përqindje, sidomos kur janë monedha të huaja. Për herën e dytë dhe të tretë, të jetë me përqindje.

Ulsi Manja – Ky sugjerim është për pikën 4, në mos gaboj, për gjerat “a”, “b” dhe “c”.

Elvis Koçi – Te pika 4, për mosdeklarimin, hera e parë të gjobitet me masë fikse 20 mijë lekë, sipas germës “a”, 40 mijë lekë, sipas germës “b” dhe 60 mijë lekë, sipas germës “c”.

Alket Hyseni – Unë sugjeroj të pranohet ky propozim, duke ruajtur masën proporcionale. Minimumi do të jetë 20 mijë lekë për germën “a”, por parimi proporcional do të vazhdojë në rritje për rastet e përsëritura, sepse herët e para shpesh vijnë nga padija, pavarësisht parimit që mosnjohja e ligjit nuk është shkak për të mos u dënuar. Duke qenë se kemi të bëjmë me një aspekt të rëndomtë rutinor, u kemi dhënë mundësi qytetarëve, që herën e parë të marrin një minimum, në të tria rastet, i cili vjen duke u rritur, por nëse është recidivist, rritet progresivisht edhe masa e dënimit.

Ulsi Manja – Për korrektësi, i keni në euro, apo në lekë?

Alket Hyseni – Janë me përqindje.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Ju lutem!

Alket Hyseni – Gjobat janë në lekë.

Ulsi Manja – Masa e gjobës duhet të jetë e shprehur në lekë .

Alket Hyseni – Në projektligj është e shprehur në lekë.

Ulsi Manja – Leku është monedha zyrtare e shtetit shqiptar.

Alket Hyseni – Kam një saktësim, kryetar.

Ulsi Manja – Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Masa e penaltetit është përherë në monedhën zyrtare, kurse referenca mund të jetë në monedhë të huaj, sepse ka shumë shtetas të huaj që vijnë dhe

Ulsi Manja – Jam dakord.

Alket Hyseni – Ne jemi në përputhje me aktet ndërkombëtare. Për shembull, BE-ja i ka në euro. Shumica e hyrje-daljeve në Shqipëri janë ...

Ulsi Manja – Jam dakord për referencat.

Alket Hyseni – Penaltetet të jenë në lekë.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 20, duke pranuar sugjerimet për pikën 4, gjerat përkatëse për masën e gjobës? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 21.

Zoti Hyseni, neni 21 “Organizimi i autoritetit përgjegjës”.

Alket Hyseni – Zoti kryetar, është propozuar një nen i ri.

Ulsi Manja – “Raportimi i Zyrës Qendrore të Pasurive të Paluajtshme”.

Alket Hyseni – Për shkak të ligjit të ri nuk do të jetë emërtimi “Zyra Qendrore e Regjistrimit”, por “Agjencia Shtetërore e Kadastrës”.

Ulsi Manja – Kush është dakord të shtohet neni i ri me këtë përmbajtje? Kundër? 3 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Diskutime pa mikrofon.)

Klotilda Bushka – Për teknikë legislative, të mos përdoret *mot a mot* “Agjencia Shtetërore e Kadastrës”, sepse mund të quhet “Organi Përgjegjës për Regjistrimin e Pasurive”.

Ulsi Manja – Të ndiqet varianti i projektligjeve të tjera.

Klotilda Bushka – Absolutisht.

Ulsi Manja – Atëherë, këshilltarët të mbajnë në konsideratë që kur të zbardhet neni i ri për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, të gjendet termi i duhur, sepse nesër mund të quhet sërish Hipoteka apo Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Alket Hyseni – Mund të bëj një ndërhyrje?

Ulsi Manja – Po.

Alket Hyseni - Përpos praktikës së përgjithshme që kemi ndjekur, këtu kemi të bëjmë me subjekte që marrin detyrim ligjor. Kjo agjenci do të ketë detyrim ligjor, nuk mund ta lëmë të paidentifikuar.

Ulsi Manja – Do ta identifikojmë, por ...

Alket Hyseni – Nuk ka rëndësi. Nëse do të preket ajo agjenci, ky ligj le të preket. Në këtë rast duhet i saktë identiteti, sepse na sjell probleme në të ardhmen.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ta vendosim saktësisht, sepse është një nga subjektet më të rëndësishme, ku janë pasuritë e paluajtshme. Nëse do të ndryshojë organizimi, do të vijë edhe ndryshimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ka problem, sepse nuk është ligj me 2/3-at.

Teknikisht sugjeroj të jetë termi “Agjencia Shtetërore e Kadastrës”. Do të marrë detyrime dhe nesër do të fillojnë...

Ulsi Manja - “Jemi ne, nuk jemi ne”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të mos mbetemi këtu, sepse ky nen është votuar.

Po, zoti Zeneli.

Alban Zeneli – Më falni që po marr atributet tuaja, por hidheni në votë me njëri-tjetrin!

Ulsi Manja – Sugjerimi i zotit Zeneli është me vlerë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Neni i ri u votua.

Kalojmë te neni 21 “Organizimi i autoritetit përgjegjës”.

Alket Hyseni – Për nenin 21, “Organizimi i autoritetit përgjegjës”, kemi draftin e grupit të punës me rekomandimet e Komisionit të Ekonomisë për pikën 1, ku sugjerohet një ndryshim dhe për pikën 2 sugjerohet një formulim në tabelë. Jemi dakord të integrohen në draftin tonë të grupit të punës të dyja propozimet e Komisionit të Ekonomisë.

Gjithashtu, ka ardhur edhe raporti i Komisionit të Sigurisë për këtë ligj dhe nuk ka sugjerime. Janë dakord me rakordimin që kemi bërë ne me grupin e punës.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 21, sipas variantit të grupit të punës? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 22.

Alket Hyseni – Për nenin 22 “Detyrat dhe funksionet e autoritetit përgjegjës”, nuk ka asnjë ndryshim.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 22? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 23.

Alket Hyseni – Për nenin 23, që ndryshon nenin 22, ka një propozim për ndryshim nga Komisioni i Ekonomisë. Në pikën 1, germa “b”, të hiqet fjalia e dytë. Dakord?

Po ashtu, propozohet të shtohet një fjali në germën “b” me formulimin që keni në draft.

Në pikën 2, shprehja “Organet e prokurorisë” të zëvendësohet me shprehjen “Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”.

Jemi dakord me rekomandimet, sipas draftit të grupit të punës.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 23, me sugjerimet e bëra nga Komisioni i Ekonomisë? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 23.

Kalojmë te neni 24.

Alket Hyseni - Në nenin 24, sipas variantit të grupit të punës, me rekomandimin e Komisionit të Ekonomisë dhe të Financave, të bëhet ndryshimi në fjalët përkatëse: “Ministri i Financave dhe Ekonomisë”. Janë çështje të teknikës legjislative dhe duhen pranuar.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 24? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 24.

Kalojmë te neni 25.

Alket Hyseni – Në nenin 25, sipas formulimit me rekomandimin e grupit të punës dhe të Komisionit të Ekonomisë kemi ndryshimin në germën “c” të pikës 2, kurse referenca në germën “gj/2” të hiqet.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 25? Kundër? 3 kundër. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Kalojmë te neni 26.

Për nenin 26, që ndryshon nenin 27 me ndryshimet e parashikuara në kolonën e fundit, Komisioni i Ekonomisë dhe Financave rekomandon rishikimin në ulje të nivelit të gjobave.

Pas këtij sugjerimi kemi bërë riformulimin “kur nuk përbëjnë vepër penale shkelet dispozita e këtij ligji, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe autoriteti përgjegjës vendos një ose disa masa administrative si më poshtë vijon” dhe rri drafti sipas kolonës së mesit.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 26, duke u pranuar sugjerimi për pikën 1? Pro? Kundër? 2 vota. Asnjë abstenim?

Miratohet.

Neni 27.

Alket Hyseni – Neni 27, me ndryshimin e emërimit të institucionit, të pranohet, duke shfuqizuar germën “d”

Ulsi Manja – Kush është pro neni 27 sipas relatorit? Kundër? 3 vota. Asnjë abstenim? Miratohet.

Kalojmë te neni tjetër.

Alket Hyseni – Kemi një nen të ri, neni 27/1, për nxjerrjen e akteve nënligjore brenda 6 muajve.

Ulsi Manja – Pra, është rënë dakord që nxjerrja e akteve nënligjore të jetë 6 muaj.

Kush është dakord që të kemi një nen të ri për nxjerrjen e akteve nënligjore brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi?

Pro? Kundër? 1 vota. Asnjë abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 28, hyrja në fuqi.

Alket Hyseni – Te neni 28 kemi pasur debat për hyrjen në fuqi. Këtu nuk ka vigjilencë, por këtu është çështja se kur do të fillojë vigjilenca.

Kemi propozime për ta futur në fuqi me dy nivele, sipas Autoritetit përgjegjës. Hyrja në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtimin që detyrimet që rrjedhin nga neni 20, pra që janë deklaratimet në kufi, penaltete përkatëse, të zbatohen nga data 1 janar 2020.

Autoriteti ka gjykuar që të ketë një periudhë informimi publik, për të mos u gjendur nga një situatë ndryshe, në një situatë që në dukje duket si jofavorizuese dhe të edukohet publiku me këto norma ligjore dhe me kushtëzimet e reja ndërkombëtare, të cilat ne i transpozojmë në legjislacion. E logjikshme është, kështu që unë them të pranohet.

Ulsi Manja – Dakord?

Atëherë kush është dakord me nenin 28 sipas propozimit që bën Autoriteti dhe që është pranuar nga relatori?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet neni 28.

E hedhim në votim në tërësi këtë projektligj.

Pro? Kundër? 2 vota. Abstenim? S’ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar””.

Drafti i zbardhur i projektligjit që u miratua bashkë me raportin përkatës të bëhen gati për seancën plenare të radhës!

Kalojmë te projektligji “Shqyrtimi nën për nen i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar””.

Do të vazhdojmë të ndjekim të njëjtën procedurë.

Kolegët kanë mbi tryezë tabelën.

Ju lutem, zoti Hyseni!

Alket Hyseni – Janë 4 kolona në tabelë. Tek e para janë numërtimi i dispozitave, tek e dyta është përmbajtja e ligjit aktual, pastaj është drafti i paraqitur dhe propozimet e grupit të punës bashkë me rekomandimet përkatëse.

Ulsi Manja – Vazhdojmë me nenin 1.

Alket Hyseni – Neni 1, i cili bën ndryshimet në nenin 3 sipas grupit të punës riformulimet do të jenë në pikën 1, në pikën 2, pas pikës 3 shtohet një paragraf 4 me përmbajtjen në kolonë.

Ulsi Manja – Këto riformulime janë të grupit të punës? Dakord.

Kush është dakord me nenin 1, sipas variantit të grupit të punës?

Pro? Kundër? 1 votë. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Ulsi Manja – Neni 2.

Alket Hyseni – Pas fjalisë së parë në pikën 4 të nenit 6 ka disa ndryshime. Ka një sugjerim nga Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, që në nenin 2, fjalët “pas fjalisë së parë në pikën 4 të nenit 6” hiqen dhe në vend të saj shtohet “pas pikës 4 të nenit 6 shtohet pika 4/1 si më poshtë” dhe konsiderohet pikë 4/1 ai formulim që ka.

Jemi dakord që të pranohet edhe propozimi i Komisionit të Ekonomisë.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 2, me sugjerimet?

Pro? Asnjë kundër? Asnjë abstenim.

Miratohet neni 2.

Kalojmë te neni 3.

Alket Hyseni – Shtohet një nen i ri. Grupi i punës ka një propozim që, pas nenit 2, të shtohet neni 2/1 me këtë përmbajtje, që në pikën 1 të nenit 7 të ketë ndryshimet e emërimit që thamë, nga Zyra Qendrore e Pasurive të Paluajtshme të bëhet Agjencia e Kadastrës.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Kush është pro shtimit të këtij neni? Kundër? S’ka. Asnjë abstenim.

Miratohet shtimi i një neni të ri.

Kalojmë te neni 3.

Alket Hyseni – Neni 3, që ndryshon nenin 10, pa ndryshime, sipas draftit të sjellë nga Këshilli i Ministrave.

Kush është pro me nenin 3 sipas draftit? Kundër? S’ka. Asnjë abstenim.

Miratohet neni 3.

Kalojmë te neni 4.

Alket Hyseni - Në nenin 4 ka pasur një rekomandim të Komisionit të Ekonomisë, me qëllim ruajtjen e proporcionalitetit dhe të balancës mes interesit publik, nga njëra anë, por edhe kufizimit të së drejtës së pronësisë, nga ana tjetër.

Ne e kemi transponuar këtë nen duke pasur një shtesë. Pas nenit 10 shtojmë nenin 10/1 me titullin “Ngrirja e përkohshme”, ku shpjegohet specifika konkrete për të bërë dallimin mes një situatë të cenimit definitiv të të drejtave të pronësisë dhe një situatë të kufizimit të përkohshëm të të drejtave të pronësisë. Kjo është bërë për të qenë në përputhje me Kushtetutën, si dhe duke zbatuar rekomandimin e Manival-it.

Ulsi Manja - Kush është pro me nenin 4, me propozimin e bërë nga relatori? Kundër? S’ka. Asnjë abstenim.

Miratohet neni 4.

Kalojmë te neni 5.

Alket Hyseni – Neni 5 është sipas draftit të qeverisë, pa ndryshime.

Ulsi Manja - Kush është pro me nenin 5? Kundër? S'ka. Asnjë abstenim.

Miratohet neni 5.

Kalojmë te neni 6.

Alket Hyseni – Neni 6 është sipas draftit të qeverisë, pa ndryshime.

Ulsi Manja - Kush është pro me nenin 6? Kundër? S'ka. Asnjë abstenim.

Miratohet neni 6.

Kalojmë te neni 7.

Alket Hyseni – Neni 7 propozohet nga grupi i punës, ndryshimet e pikës 2 me formulimin përkatës, që të bëjmë këto ndryshime: fjalët “jo më shumë se 30 ditë punë zëvendësohen me “jo më shumë se 45 ditë”; në fund të fjalisë së dytë shtohet shprehja “si dhe subjektet e pabashkuara në nenin 10 të këtij ligji”.

Ulsi Manja - Kush është pro me nenin 7, me propozimet e relatorit? Kundër? S'ka. Asnjë abstenim.

Miratohet neni 7.

Kalojmë te neni 8.

Alket Hyseni – Neni 8, me ndryshimet e propozuara nga grupi i punës, që në pikët 1 të ketë ndryshimin, sipas formulimit të bërë më poshtë: Në pikën 2 shtohet pika 4/1 me shprehjen “kur besohet se janë mbledhur prova të mjaftueshme” të zëvendësohet me shprehjen “kur rezulton se ka prova të mjaftueshme që krijojnë dyshimin e arsyeshëm për përfshirjen e personit ose subjektit përkatës, për të cilin kërkohet shpallja për vepra të terrorizmit ose financimit të terrorizmit”.

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave është dakord, pro kërkon një saktësim, shprehja “sipas pikës 3”, bëhet “sipas pikës 2”. Pra, thotë autoriteti përgjegjës. Rezerva për pikën e dytë, sepse sipas kriterëve....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, po, për të sqaruar të tjerët.

Ulsi Manja – Pra, për nenin 8 janë pranuar ndryshimet e grupit. Keni bërë ndryshime në nenin 8. Po për sugjerimin që bën drejtoria?

Alket Hyseni – Dakord, sepse jemi në rastet kur nuk ka nevojë për prova të qenësishme, por mjaftojnë provat që sjellin dyshimin e arsyeshëm.

Ulsi Manja – Atëherë, kush është pro nenit 8? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet neni 8!

Kalojmë te neni 9.

Alket Hyseni – Neni 9 nuk ka ndryshime, por sugjerohet specifikimi, nëse afatet do të caktohen në ditë pune apo në ditë kalendarike. Autoriteti përgjegjës sugjeron të hiqet, bazuar në ndryshimet e tjera, me qëllim shpejtësie në zbatimin e masave, bazuar në mekanizmin e ngrirjes. Jam dakord me propozimin e autoritetit.

Ulsi Manja – Pra, autoriteti kërkon ditë pune.

Alket Hyseni – Të hiqet fare si parashikim.

Ulsi Manja – Të hiqet fare.

Alket Hyseni – Të hiqet. Nuk ka nevojë të jetë...

Ulsi Manja – Ditë pune ose ditë kalendarike.

Alket Hyseni – Jo, është termi “menjëherë”. Nuk ka nevojë të jetë fare dy ditë apo tre ditë.

Ulsi Manja – Dakord!

Atëherë, kush është pro nenit 9, me sugjerimin e bërë nga autoriteti? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet neni 9.

Ka një nen të ri.

Alket Hyseni – Është nen i ri. Pas nenit 9 shtohet neni 9/ 1, i cili në nenin 22, pika 4 ndryshohet me këtë përmbajtje, dhe përmbajtjen e keni, një paragraf i vetëm, duhet pranuar.

Ulsi Manja – Kush është dakord të kemi një nen të ri, i cili bën fjalë për procedurat dhe rregullat e marrjes në administrim?

Pro? Kundër s’ka. Asnjë abstenim.

Miratohet shtimi i një neni të ri!

Kalojmë te neni 10.

Alket Hyseni – Neni 10 nuk ka ndryshime, sipas variantit të qeverisë.

Ulsi Manja – Pra, neni 10 nuk ka ndryshime.

Kush është pro nenit 10, sipas draftit? Kundër s’ka. Asnjë abstenim.

Miratohet neni 10.

Kalojmë te neni 11.

Alket Hyseni – Neni 11 ka ndryshimet e përcaktuara në pikën 2, në pikën 3, që i keni në kolonë, si dhe në pikën 4, por ka një rezervë nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, pasi propozimi përcakton organin, i cili ka të drejtë për të të paraqitur kërkesë pranë OKB-së, ndërsa në propozimin fundit kjo çështje nuk rregullohet, kështu që duhet pranuar sugjerimi i autoritetit përgjegjës.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 11, duke pranuar propozimin e autoritetit, të agjencisë? Pro? Kundër s’ka. Asnjë abstenim.

Miratohet neni 11.

Kalojmë te neni 12.

Alket Hyseni – Është nen i ri, para nenit 12.

Ulsi Manja – Po. Kërkoj ndjesë!

Alket Hyseni – Sugjerohet që pas nenit 11 të shtohet neni 11/ 1 dhe 11/ 2, sipas propozimit të mëposhtëm. Një pjesë janë të teknikës legislative.

Ulsi Manja – Janë çështje të teknikës legislative. Kudo në ligj, fjalët “ministri i Financave” zëvendësohet me fjalët “ministri përgjegjës për Financat”.

Alket Hyseni – Ndërkohë, ngarkohet Këshilli i Ministrave që... Afati është i papërcaktuar aty. Gjashtë muaj, le të ruajmë të njëjtën linjë që përcaktuam edhe te ligji tjetër, sepse kjo janë në paketë dhe duhet të paraqiten si paketë.

Ulsi Manja – Po, zoti Zeneli.

Alban Zeneli – Faleminderit, zoti kryetar!

Normalisht, ky është një projektligj i rëndësishëm, ndaj unë, në emër edhe të kolegëve të mi, dua të shpjegoj votën tonë pro këtij projektligji. Është e rëndësishme që të luftohen fenomene si terrorizmi, të cilat cenojnë rëndë sigurinë e jetës e të pronës së shqiptarëve. Prandaj e mbështesim këtë projektligj, siç do të mbështesim edhe çdo projektligj që vjen në këtë komision, i cili ka të bëjë me interesat parësore të të gjithë qytetarëve shqiptarë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Zeneli!

E hedhim në votim. Kush është dakord me shtimin e një neni të ri? Pro? Kundër s’ka. Asnjë abstenim

Miratohet!

Kalojmë te neni i fundit, që është neni 12.

Alket Hyseni – Neni 12: “Hyrja në fuqi pesëmbëdhjetë ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”.

Ulsi Manja – Është hyrja në fuqi e ligjit. Kush është dakord me nenin 12? Pro? Kundër s’ka. Asnjë abstenim.

Miratohet!

Hedhim projektligjin në votim në tërësi.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Pro? Kundër s’ka. Asnjë abstenim.

Miratohet në tërësi projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar.

Drafti i projektligjit që u miratua në komision, duke bërë edhe numërtimet përkatëse aty ku ka shtime të neneve të reja, gjithashtu edhe raporti, të bëhen gati për seancën plenare.

Falënderoj edhe kolegët e opozitës, që u bashkuan në votimin e këtij projektligji. Edhe unë jam plotësisht dakord me ato çfarë tha kolegu Zeneli.

Falënderojmë përfaqësuesit e agjencisë. Shumë faleminderit për prezencën! Urime edhe për paketën e pesë projektligjeve që erdhën në kuadrin e MANIVAL-it! Shpresojmë se pas votimit në seancën plenare, t’i shërbejmë qëllimit për të cilin i miratuam.

Shumë faleminderit dhe ditë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.06.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Elena Xhina, Alket Hyseni, Spartak Braho, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Ediola Braha, Alban Zeneli, Xhemal Qefalia, Edlira Bode dhe Ralf Gjoni.

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Damian Gjiknuri, Bashkim Fino, Edmond Leka, Jurgis Çyrbja, Andi Përmeti, Elda Hoti dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Artan Syziu – Përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë

Gianluigi Pratola - Ekspert ndërkombëtar nga EURALIUS

Ulsi Manja – Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës. Pikën e tretë të rendit të ditës e kemi në vazhdim. Është shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27. 01. 1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Jemi komision përgjegjës. Kjo është një nismë e një grupi deputetësh të maxhorancës në Kuvendin e Shqipërisë. Si komision përgjegjës, në shqyrtimin e këtij projektligji kemi caktuar relatore kolegen Elena Xhina. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen:

Nga Ministria e Drejtësisë zoti Syziu, i cili është përgjegjës në Sektorin e Studimeve Juridike dhe Analizës.

Ka përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem! T’i prezantoj. Le të zëmë vend me qetësi, sepse karrige ka sa të doni.

Nga Ministria e Shëndetësisë, ka përfaqësues? Nuk ka.

Nga misioni EURALIUS? Po, nga Misioni EURALIUS është Gianluigi Pratola, ekspert ndërkombëtar.

Po nga Ministria e Brendshme?

Në fakt, ishte zëvendësministri, zoti Hodaj, dhe do t’i bashkohet komisionit.

Nga Prokuroria e Përgjithshme është zoti Kujtim Luli, prokuror.

Po nga Autoriteti Kombëtar i ushqimit? Mund të afroheni pak! Është zoti Tabaku.

Kemi përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë. Po, kemi edhe përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë.

Nga “Avokati i Popullit” kemi prezentë zotin Haxhimihali dhe zotin Nezha.

Edhe nga Ministria e Mjedisit kemi prezentë. Është zonja Marika.

Zonja Xhina, e kemi lënë tek neni...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elena Xhina – Po, zoti kryetar! Herën e kaluar mbaruam nenin 3, e hodhëm në votim, ndërsa sot do të vijojmë me nenin 4.

Ulsi Manja – Pra, jemi te neni 4: “Organizimi i lojërave të palejuara”.

Ju lutem kolegë, përpara keni tabelën e integruar të ndryshimeve!

Edhe një herë sjell në vëmendjen e kolegëve të komisionit, se në këtë paketë ndryshimesh në Kodin Penal kanë qenë katër komisione të tjera të përhershme të Kuvendit, si komisione për dhënie mendimi. Tashmë, relatorja dhe këshilltarët e komisionit, së bashku edhe

me kolegët, kemi raportet e të katër komisioneve, të cilat kanë qenë të përfshira në këtë paketë ndryshimesh të Kodit Penal.

Një pjesë e këtyre sugjerimeve janë marrë në konsideratë nga relatorja dhe grupi i punës, por kur të jemi në shqyrtimin nen për nen, besoj se do të ishte mirë të sqarohej se cili variant ose cili propozim i kolegëve të tjerë të komisionit është pranuar.

Neni 197: “Organizimi i lojërave të fatit”.

Elena Xhina – Po, zoti kryetar, neni në lidhje me nenin 197 nuk kemi pasur sugjerime konkrete nga komisioni, dhe reflektimi i ndryshimeve është produkt i grupit të punës. Aty fillojnë ndryshimet që në titullin e dispozitës. Është menduar të bëhet: “Organizimi dhe ushtrimi i lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin”.

Nga ana tjetër, është bërë një propozim, që në paragrafin e parë të shtojmë togfjalëshin: “kur është marrë më parë një masë administrative”. Kjo bëhet me qëllim që të ndahen rastet kur të njëjtat shkelje mund të përbëjnë edhe kundërvajtje administrative, si dhe vepër penale.

Gjithashtu, në ndryshim nga propozimi i deputetëve nismëtarë, është duke u parë ligji “Për lojërat e fatit”. Janë hequr fjalët: “lotari” e “bixhoz”, pasi këto ligji për lojërat e fatit nuk i ka të ndara shprehimisht në këtë lloj forme.

Gjithashtu, është menduar që paragrafi i fundit, i cili fliste për pjesëmarrjen në lojërat e fatit, që e penalizonte atë dhe e bënte vepër penale, të mos jetë më pjesë e draftit.

Ulsi Manja- Ju lutem!

Zonja Xhina, dua të di për nenin 197, se çfarë ndryshon nga varianti i depozituar i nismëtarëve, si për sa u përket paragrafëve, masave të dënimit dhe për çfarë është pranuar?

Elena Xhina - Kemi ndryshimin që në titull. Më pas kemi shtuar në paragrafin e parë faktin se kur më parë është marrë masë administrative do të përbëjë vepër penale. Masa e dënimit nuk është ndryshuar, vazhdon me burgim nga 1-3 vjet.

Për sa i përket paragrafit të fundit kemi menduar të hiqet, nuk duhet të jetë fare si paragraf, pasi ky nen, njëlloj si pjesëmarrja në lojërat e fatit, menduam se nuk do të sillte ndonjë risi apo ndonjë parandalim të këtyre fenomeneve. Grupi i punës propozon që të mos jetë pjesë e draftit.

Nga ana tjetër, kemi menduar që paragrafi i tretë, kur kjo vepër penale kryhet nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore apo me shërbim publik të shtohet me pas fjala që është propozimi i sotëm, i cili ka lidhje me veprimtarinë e lojërave të fatit. “Dënimi me burgim shtohet me një të katërtën e dënimit të dhënë”.

Paragrafi i tretë ka ndryshim nga paragrafi i propozuar, por me një sugjerim të grupit të punës të shtohen fjalët: “Që kanë lidhje me veprimtarinë e lojërave të fatit”.

Zoti kryetar, nëse lind nevoja, mund ta lexojmë të gjithë dispozitën që të jemi më të qartë.

Ulsi Manja – E keni tabelën përpara. E përmbledhim përfundimisht të gjithën, që të dimë se çfarë do të kalojmë në votim.

Elena Xhina – Neni 197 “Organizimi dhe ushtrimi i lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin”. “Organizimi dhe ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin, kur është marrë më parë masë administrative dënohet me burgim nga 1-3 vjet. Po kjo vepër kur në lojë marrin pjesë persona nën moshën 18 vjeç dënohet me burgim nga 2-5 vjet. Kur kjo vepër kryhet nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore apo në shërbim publik që kanë lidhje me veprimtarinë e lojërave të fatit, dënimi me burgim shtohet me një të katërtën e dënimit të dhënë”.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Kush ka pyetje nga kolegët?

Po, zoti Zeneli.

Alban Zeneli – Faleminderit, zoti kryetar!

Vë re se ky projektligj ka *nonsens*, të paktën në aspektin formal. Ky projektligj i ardhur në këtë komision të nderuar ka dy momente që duhet t’i shikojmë. Së pari, ne si ligjvënës duhet të jemi shumë korrektë me qytetarët shqiptarë ose duhet ta heqim fare si fenomen apo si biznes pjesën e lojërave të fatit, sepse nuk mund të kemi dy standarde me qytetarët shqiptarë. Nga njëra anë u japim të drejtë disa njerëzve apo disa shoqërive për të organizuar këtë biznes, nga ana tjetër i penalizojmë ata që luajnë. Për mendimin tim ose ta heqim fare dhe të kthehemi përpara 40 vjetëve siç ka qenë atëherë, kur ishte i ndaluar bixhozi apo lojërat e fatit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ta heqim atëherë. Pse ta lemë në qendër të Tiranës dhe ta organizojë dikush, kurse dikush tjetër jo? Çfarë ndryshimi ka? Më mirë ta heqim fare, me qëllim që ju, qeveria juaj, Kryeministri juaj të jetë i pastër përpara të gjithë qytetarëve shqiptarë të heqë edhe kazinonë në mes të Tiranës dhe të mos i penalizojë qytetarët shqiptarë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, ata që duan të luajnë bixhoz, le të luajnë, ata që nuk duan, të mos luajnë, se nuk është kjo formë për ta penalizuar apo për të hequr atë fenomen që është negativ për shoqërinë shqiptare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si e heq këtë fenomen, duke e lënë në qendër të Tiranës dhe në pjesën tjetër jo?

Ulsi Manja – Zoti Zeneli, edhe sot është vepër penale. Pa dalë ndryshimet që iu bënë ligjit “Për ndalimin e lojërave të fatit” ne e kishim në Kodin Penal organizimin e paligjshëm të lojërave të fatit.

Alban Zeneli - T’i heqim fare kazinotë, kjo është më e mira.

Ulsi Manja – Thjesht po e harmonizojmë dispozitën me ligjin e ri që ka miratuar Kuvendi.

Faleminderit!

Po, zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Faleminderit, zoti kryetar!

Shikoj se shkrimi në mënyrë juridike nuk ekziston te ky nen. Duke parë se neni penalizon rishtas këtë kundërvajtje apo vepër penale, mendoj të fillojë nga paragrafi i fundit: “Pjesëmarrja në lojërat e fatit”. Të mos hiqet “dënohet me gjobë”, të fillojë me gjobë dhe pastaj me heqje lirie.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është shumë e rëndë, e fillon direkt me burg. “Pjesëmarrja në lojërat e fatit që zhvillohen në kundërshtim me ligjin dënohet me gjobë”. Kjo të vendoset në paragrafin e parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Nuk ka rëndësi.

Zonja Xhina, ai nuk është për ta hequr, por për ta lënë me sanksion, me gjobë.

Adriatik Alimadhi - Ta fillojmë paragrafin, duke vënë veprën penale me gjobë.

Ulsi Manja - Zonja Xhina, a ka mundësi? Nuk jemi në grup pune, por në diskutim në Komisionin e Ligjeve.

Zoti Aliamdhi ka përpara draftin dhe thotë: “Pjesëmarrja në lojërat e fatit që zhvillohen në kundërshtim me ligjin dënohet me gjobë ose me burgim deri në 1 vit”. Ai thotë të qëndrojë në dispozitë, por të dënohen vetëm me gjobë, me sa kuptoj. Ju si relatore keni propozuar të hiqet fare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Xhina, a ka mundësi?

Jeni relatore e projektligjit dhe e prezantuat atë.

Zoti Luli, si përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme, a keni ndonjë gjë në lidhje me nenin 4?

Kujtim Luli – Në lidhje me nenin 197 të ndryshuar, dua të them se është një nen, i cili ka ekzistuar në Kodin Penal. Me sa shikohet qëllimi i ligjvënësit është për të ashpërsuar ndëshkimin, veçanërisht për ato vepra të ndaluara me ligjin e posaçëm. Ligji i posaçëm nr.

75/2018 në dispozitën kalimtare ka ndaluar bastet sportive, bastet për gara në pistë, lojërat elektronike në distancë dhe një kategori tjetër të lojërave të fatit. Në këtë këndvështrim unë vlerësoj që në paragrafin e parë të hiqen fjalët: “Kur është marrë më parë masa administrative”, sepse edhe te ligji i mëparshëm nuk ka qenë, ka qenë më e zbutur dispozita. Tani po shkojmë në një dispozitë që ashpërsohet ndëshkimi veçanërisht për lojërat e fatit të ndaluara. Pra, ne jemi për ta hequr, kur është marrë më parë masa administrative. Në paragrafin e dytë vendosja e këtij togfjalëshi në aspektin praktik pengon zbatimin e dispozitës penale, sepse ne kemi eksperiencën e zbatimit të nenit 180 që bën fjalë për masat administrative në fushën e tatimeve. Ndërsa në paragrafin e dytë, mendoj që të shtohet një fjalë te pjesa: “kur në lojë janë lejuar të marrin pjesë”. Pra, këtu nuk janë subjekte të miturit dhe përgjegjësinë për pjesëmarrjen e të miturve në këtë lojë e kanë ata që e lejojnë. Në këtë kuptim del i qartë formulimi: “Kur në lojë janë lejuar të marrin pjesë”. Pra, të shtojmë vetëm fjalët: “janë lejuar”, ose “lejohej të marrin pjesë”. Po kjo vepër, kur në lojë lejohet të marrin pjesë personat nën moshën 18 vjeç dënohet. Të shtohet kjo, sepse nuk janë subjekte të miturit, por ata që i lejojnë të marrin pjesë. Kështu del më i qartë formulimi i dispozitës. Këto janë sugjerimet.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Luli!

Po, zoti Zeneli.

Alban Zeneli – Kam një pyetje në lidhje edhe më këtë që sapo tha zotëria i nderuar. Në këtë vepër, kur në lojë marrin pjesë persona nën moshën 18 vjeç, me sa kuptova, dënimi është vetëm për organizatorët apo edhe për të miturit që marrin pjesë?

Kujtim Luli – Formulimi e qartëson, vetëm organizatorët duhet të paralizohen për lejimin e të miturve në lojë.

Ulsi Manja - Zoti Zeneli, mund të vazhdoni me pyetjet.

Alban Zeneli – Me pyetje, por edhe me një lloj sugjerimi.

Mendoj se masat për këtë fenomen janë më shumë se drastike, në një kohë kur në shoqërinë tonë ka dënime për krime edhe më të rënda dhe dënohen më pak se në këtë rast. Të dënosh dikë që luan bixhoz apo organizon lojëra të palejueshme... Ky është një fenomen absolutisht i dënueshëm, por për mua, dënimet nuk janë të duhurat, sepse për krime shumë më të rënda në Shqipëri dënohesh 2-5 vjet dhe për të njëjtin fenomen, normalisht, nuk ka pse të jetë një dënim kaq i rëndë, se nuk shoh të ketë ndonjë interes shumë të madh për shqiptarët, kur dikush bën një vrasje dhe dënohet 2-7 vjet dhe për të njëjtin fenomen dënohet...

Nuk e kam me ju, por me komisionin.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Zeneli!

Do t'ju lutesha, nëse keni propozime për nenin 197, edhe për ekonomi kohe, të jeni konkretë!

Po, zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Në fakt, më shumë desha një mendim nga prokurori.

Zoti prokuror, duke e parë në tërësi, ky nen fillon direkt me burg. Nga eksperiencia juaj, a mos ndoshta është e ngarkuar që kjo vepër penale, që parashikohet në këtë nen, të jetë direkt me burg? Me sa shoh, organizimi i lojërave të palejuara fillon direkt me burg, kur ne kemi kaluar nene të tjera për vepra penale edhe më të rënda...

Kujtim Luli – Në vlerësimin tim, bëhet fjalë për një vepër penale, që, po themi, është ndryshuar me synimin për të ndëshkuar rastet e ndaluara me ligj për lojërat e fatit. Tashmë ligjvënësi e ka shprehur vullnetin e tij me ligjin e posaçëm, duke ndaluar në mënyrë të posaçme disa kategori lojërash fati, që kanë qenë fenomene në shoqërinë shqiptare, madje kanë sjellë edhe pasoja në familjet shqiptare. Në këtë këndvështrim, ndalimi me ligj dhe penalizmi i kësaj veprë penale... Gjykoj se duhet ashpërsuar edhe masa e dënimit për këto lojëra të ndaluara, se deri dje të gjitha kanë qenë të lejuara. Megjithatë, ka pasur një vepër penale që fillonte me gjobë. Tani, ligjbërësi ka ndaluar një kategori veprash dhe, duke i ndaluar, në vlerësimin tim, duhen ashpërsuar. Mund të mos fillojë nga 1 vit burg, por me burgim deri në 3 vjet.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Luli!

Zoti Hyseni e ka kërkuar fjalën.

Alket Hyseni – Së pari, për sa i takon këtij debati, mendoj se kjo gjë duhet të jetë. Ne kemi edhe një koherencë me qëndrimin e politikave penale që kemi mbajtur. Për shembull, për vepra në fushën e taksave dhe tatimeve, ne e kemi kushtëzuar këtë me aktin administrativ të procedimit. Duhet ta ruajmë këtë frymë.

Shqetësimi im është pjesa tjetër e debatit. Kjo është një dispozitë, e cila ka dy elemente brenda saj, organizmin dhe ushtrimin. “Organizimi” janë subjektet që e kanë vetë biznesin, kurse “ushtrimi” janë ata që luajnë. Pra, duhet të kuptojmë diferencën.

Paragrafi i dytë nuk e specifikon këtë ndarje dhe unë mendoj se duhet riformuluar, sepse qëllimi ynë, si propozues, ka qenë që vetëm organizatori të jetë si rrethanë rënduese në paragrafin e dytë, pra ata që organizojnë lojëra me persona nën 18 vjeç. Propozimi është ky: “Organizmi i lojërave, kur në lojë marrin pjesë persona nën 18 vjeç”, pra shtohet “organizmi i lojërave të fatit”. Dakord?

Ulsi Manja – Personalisht, mendoj se paragrafi i dytë është i lidhur *mot a mot* me të parin. Nuk mendoj se në paragrafin e dytë duhet shtuar fjala “organizimi”, sepse nënkuptohet që është për organizatorët.

Alket Hyseni - Kryetar, ky ka qenë qëllimi, por kur thuhet “po kjo vepër”, dënohet vepra. Në titull është edhe organizimi, edhe ushtrimi. Thuhet: “Po kjo vepër...”. Shkojmë te pyetja: cila është vepra? Titulli është vepra, “organizmi dhe ushtrimi”, se i ka të dyja. Prandaj nuk na kushton gjë të themi se organizmi i lojërave, kur marrin pjesë persona nën 18 vjeç, është rrethanë rënduese....

Ulsi Manja – Po ushtrimi i veprimtarisë së paligjshme?

Alket Hyseni – Ushtrim është kur luan.

Ulsi Manja – Jo.

“Ushtrimi i veprimtarive”, pra flitet për veprimtari.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – Nuk është “veprimtarive”, por “ushtrimi i lojërave të fatit”.

Ulsi Manja - “Organizmi dhe ushtrimi i veprimtarive të lojërave.”

Alket Hyseni – Kryetar, titulli përbën veprën, tjetër gjë... Nëse është tek titulli, hajde ta korrigjojmë titullin pastaj, se e kemi “organizmi dhe ushtrimi i lojërave të fatit”. “Ushtrimi i lojërave të fatit” është edhe loja. Ky është një term i gjerë.

Ulsi Manja – Mund ta shtoni fjalën “veprimtarive” dhe mbyllet në titull.

Alket Hyseni – Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, kur e propozuam, synimi ishte të kishim dy rrethana rënduese, një për organizatorët dhe një për organizatorët kur janë punonjës të shtetit.

Ulsi Manja – Nëse duhet shtuar në titull fjala “veprimtari”, e shtojmë, por në variantin si e riformuloi relatorja në fund, neni 197, mendoj se del qartë që këtu është fjala për të penalizuar organizimin dhe ushtrimin e veprimtarive të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin, rrethanë rënduese kur personat janë nën 18 vjeç dhe rrethanë rënduese edhe kur këto veprimtari kryhen nga persona të ngarkuar me funksione shtetërore apo me shërbim publik. Propozohet të hiqet penalizimi i pjesëmarrjes në lojërat e fatit. Pra, ai që e ka ves, nuk ka pse të dënohet kur ti nuk je në gjendje të penalizosh këtë që e organizon. Pra, edhe unë e shoh të drejtë heqjen nga Kodi Penal, sepse nuk ka pse të dënosh atë që luan. Ai që luan është një qytetar i zakonshëm, që kur të gjejë një bastore të hapur, në kundërshtim me ligjin, do të shkojë të luajë, por ne nuk mund t’i fusim qytetarët në burg. Pra, në shtëpi mund të luajnë sa të duan ata dhe Zoti ua priftë mbarë.

Relatorja na dha këtë variant. Unë jam dakord me zotin Luli, por kërkoj edhe mirëkuptimin tuaj që masa administrative këtu është e tepërt dhe në kundërshtim me ligjin. Pse është e tepërt? Ligji i ka ndaluar tërësisht lojërat e fatit, por një pjesë e këtyre lojërave vazhdojnë të lejohen. Pra, për këto lojëra, që janë ndaluar shprehimisht nga ligji, nuk vlen koncepti “kur më parë janë marrë masa administrative”, sepse ose janë të mbyllura, ose nuk janë. Kështu që unë mendoj se varianti, që ne kemi propozuar në fillim si deputetë, ka qenë më mirë.

Fjalën e ka zoti Zeneli për të bërë një sugjerim dhe më pas zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Më falni, por kam një pyetje në vazhdimësi. Unë i kërkoja një mendim prokurorit, i cili e dha në mënyrë të saktë. Unë kërkoj që ky nen të hidhet në votim, pasi edhe propozimi që ju bëtë ishte konkret, sepse kjo vepër dënohet me burgim nga 2 deri në 5 vjet. Me sa kuptova unë, prokurori tha deri në 3 vjet, apo jo?

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Këtë do ta përmbledhim në fund.

Alket Hyseni – Zoti prokuror, ndalohet kontrabanda se është vepër penale, por si vepron Autoriteti Doganor kur konstaton se ka kontrabandë? A nuk vendos ai penalitet administrativ? Pra, i vendos penalitet administrativ dhe më pas e kalon në ndjekje penale, kështu që mos i ngatërroni gjërat. Kjo është një vepër me të cilën është ndaluar, por autoriteti përgjegjës, i cili mbikëqyr lojërat e fatit, edhe kur konstaton një veprimtari të ndaluar nga ligji, mban procesverbalin përkatës dhe jep penalitetin përkatës administrativisht nëse ka elemente të veprës penale dhe më pas vepron për fazën e dytë. Pra, mos i ngatërroni gjërat se edhe herën e kaluar e kemi diskutuar dhe kemi ruajtur një koherencë me legjislacionin. Pra, ne nuk duhet ta bëjmë ndryshe këtu dhe ndryshe të ligji tjetër, sepse ne jemi një; jemi Republikë e Shqipërisë dhe do të mbajmë një frymë dhe kjo bën sens të plotë. Autoriteti, edhe kur e ndalon në mënyrë kategorike, shkon atje, e konstaton dhe i vendos gjobë.

Ulsi Manja - Është shprehur Kodi Doganor për këtë gjë.

Alket Hyseni – E ka edhe ligji, si nuk e ka.

Ulsi Manja – Zoti Hyseni, ju lutem, sepse kam një pyetje.

Unë nuk e njoh shumë mirë Kodin Doganor, por di që ky kod e lejon këtë pjesë të ndëshkimit administrativ deri në njëfarë vlere të mallrave që dihet se janë kontrabandë, por, gjithsesi, dua ta shmang këtë pjesë të bisedës. Në konceptin tim, nëse një gjë është e ndaluar me ligj, nuk mund t’i jepet shansi i kundërvajtjes administrative.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në cilin ligj?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Te ligji i lojërave të fatit? Atëherë, ma gjeni se ku e ka të shënuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka një mendim zoti Luli dhe më pas zoti Pratola nga misioni EURALIUS, që mund na ndihmojë në këtë drejtim, por unë di që ligji, që kemi miratuar për lojërat e fatit, nuk e ka lënë këtë hapësirë. Gjithsesi, unë nuk e kam përpara ligjin që ta verifikoj.

Po, zoti Luli.

Kujtim Luli – Dua të bëj një sqarim teknik. Tek asnjë nga veprat penale, që lidhen me kontrabandën, nuk bëhet fjalë për masa administrative, sepse është vetëm një vepër penale, është neni 181 që bën fjalë për mospagimin e taksave dhe tatimeve. Kjo është një vepër penale e veçantë, duke favorizuar taksapaguesit, që, nëse nuk i përmbushin detyrimet përpara se të ndëshkohen penalisht, ata duhet të jenë të dënuar administrativisht. Kjo është në vepër penale e parashikuar në nenin 181 dhe vendosja e masave është një teknikë e pranuar në kod, por për rastin, që kemi në shqyrtim, unë nuk e vlerësoj se duhet të shkojmë në këtë nivel.

Ulsi Manja – Ju lutem, a ka ndonjë mendim tjetër?

Po, zoti Zeneli.

Alban Zeneli – Faleminderit, zoti kryetar!

Dua një sqarim nga relatorja, por edhe nga zotërinjtë e nderuar që janë këtu. Projektligji përcakton që organizimi dhe ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin, kur është marrë më parë një masë administrative, dënohet me burgim nga 1 deri në 3 vjet. A është parashikuar në projektligj që edhe organizatori, edhe lojtari të dënohen njëloj?

Ulsi Manja – Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Nëse do ta lexojmë me vëmendje, thuhet: “Organizmi dhe ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit”. Pra, ai që luan, ai që ushtron veprimtarinë, që mund të jetë organizatori që ka hapur një NIPT në qendër dhe ushtruesi është në një qytet tjetër, që ka licencën për ta ushtruar aktivitetin. Atëherë, ka ardhur një draft nga deputetët nismëtarë, të cilit duhet t’i përmbahemi.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Xhina!

Po, zoti Zeneli.

(Diskutime pa mikrofon)

Prandaj thuhet “nga 1 deri në 3 vjet” sepse mund të jetë nga 1 për ushtruesin e veprimtarisë dhe mund të shkojë deri në 3 vjet për organizatorin. Kjo është çështje diskrecioni e hetimit dhe e gjykatës. Nuk mund ta vendosim në këtu që ushtruesi i veprimtarisë të dënohet 1 vit dhe organizatori 3 vjet. Ne nuk jemi as prokurori dhe as gjykatë.

Alban Zeneli – Por duhet të ndahen, organizatori më vete dhe ushtruesi më vete. Zoti kryetar, ne nuk mund të futin në të njëjtin nen të njëjtin dënim, si për atë që e organizon lojërat e fatit, ashtu dhe atë që luan...

Ulsi Manja – Nuk bëhet fjalë për atë që luan, e keni kuptuar gabim.

Të lutem, mos na lodh, sepse flitet për organizim dhe ushtrim veprimtarie, kurse ai që luan nuk dënohet.

Zoti Nezha ka një mendim dhe më pas fjala për zotin Pratola.

Ardian Nezha – Ne kemi vetëm një propozim lidhur me emrin e dispozitës. Pas diskutimeve që u bënë këtu, mendoj që të ndryshojë vetëm terminologjia “... organizimi dhe/ose ushtrimi i lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin”. Janë dy aktivitete të ndryshme dhe nuk mund t’i fusim në të njëjtën dispozitë, sepse e pengojnë njëra-tjetrën. Unë mendoj se lidhëza “dhe” nuk ka vend këtu. Pra, duhet të jetë “...organizimi ose ushtrimi i lojërave të fatit”.

Ulsi Manja - Unë do të doja të dëgjoja edhe mendimin e ekspertëve, sepse organizimi dhe ushtrimi kërkojnë një mënyrë komulative, nëse do të përdorim lidhëzën “dhe” është mënyrë komulative, por, nëse do të penalizojmë organizimin, më vete dhe ushtrimin më vete, patjetër që duhet hequr lidhëza “dhe”.

Ushtrimi mund të jetë në një rreth tjetër, organizatori është në Tiranë, ka një pikë bastesh në një rreth tjetër, gjithsesi kjo është diçka që mund të vendoset.

Zonja Mara, e ka fjalën.

Aurora Mara – Unë mendoj që ideja e ushtrimit ngatërrohet me ushtrimin e lojës. Pra, ne duhet ta mendojmë pak më gjerë, se organizimi dhe ushtrimi, sipas meje duhet të ndahen nga njëra-tjetra, sepse ta organizosh është diçka tjetër dhe ta ushtrosh një lojë është diçka tjetër. Veprimtaria është veprimtaria e lojës, kështu që mund të ushtrohet veprimtaria e lojës, por varet se si interpretohet.

Ulsi Manja – Ju lutem, unë jo më kot i kam thirrur gjithë këta ekspertë këtu, nga prokuroria, nga ministria, ekspertë të Euralius-it, sepse ne jemi në një nivel shqyrtimi dhe miratimi dhe deri diku kemi vlerësimet dhe gjykimet tona, që mund të jenë juridike, por përtej kësaj mund të jenë edhe politike. Nisma dhe paketa që kur janë iniciuar kanë pasur si qëllim ashpërsimin e masave të dënimit për një grup veprash penale në Shqipëri, që kanë të bëjmë me sigurinë ushqimore, sigurinë mjedisore, sigurinë e rendit publik, lojërat e fatit patjetër, si një reflektimi i ligjit të ri që kemi dhe kështu me radhë.

Çështjet e masave të dënimit nuk besoj se mund të jenë objekt i një debati të gjerë në këtë komision, për sa kohë që kemi rënë dakord se do të kemi këtë politikë penale ne si propozues. Ne kemi thënë që ushtrimi dhe organizimi i veprimtarive të lojërave të fatit të

dënohet nga 1 deri 3 vjet, ky është qëndrim, nuk është çështje teknike, i kësaj shumice parlamentare që e ka propozuar këtë ndryshim. Sa u takon çështjeve që kanë të bëjnë me adresimin e shqetësimeve, që kanë të bëjnë me teknikën legislative, me harmonizimin me strukturën e Kodit Penal për ta përshtatur me gjuhën dhe strukturën që ka Kodi Penal, jemi të hapur, ndërsa për çështje të tjera jo të jetë 1 deri në 3 apo 3 deri në 5 e gjitha është vullnet politik. Unë mendoj se duhet të jemi të gjithë të qartë dhe të mos bëjmë debate si kolegë në komision, sepse unë më pas e kam detyrim, sipas Rregullores, që, kur ka propozim alternativ dhe formulim konkret, ta hedh në votë, ndryshe do të ngelemi vetëm te një nen. Ka 40 minuta dhe kemi ngelur te një dispozitë që është “Organizimi i lojërave të fatit”.

Ju lutem, kërkoj mirëkuptimin e kolegëve, por dhe të pranishmëve!

Të dy nga një konsideratë dhe më pas do të vazhdojmë nen për nen.

Po, zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Përderisa ju citoni që ky është orientim...

Ulsi Manja – Jo orientim...

Adriatik Alimadhi – Ju lutem, më lini ta mbaroj fjalën!

Pra, përderisa ju thoni që është vendim i maxhorancës, atëherë nuk e nuk di nëse në këtë komision ka pozitë dhe opozitë apo jeni vetëm ju. Në qoftë se si koncept e shprehni me mënyrën se do të vendosim ne se s’bën, unë e shoh të tepërt vendin në këtë komision.

Zotërinj, ka një gjë, në arsyetimin dhe mendimin tim shoh që është një vepër, pavarësisht se është bërë nga politikat e kësaj qeverie, ka ngarkesë si vepër penale. Duke e filluar si një vepër penale të re këtu hiqen të gjitha dhe me fjalën “burgim” e tmerrojmë publikun, duke u thënë nga 3 deri në 5, nga 2 deri në 4 apo nga 1 deri në 3.

Në qoftë se ju thoni me vota dhe mos ta diskutojmë në komision, për mua përbën sens juridik dhe nuk e di, si dhe kërkoj nga ju mos ta përsërisni më, sepse jemi mësuar shpeshherë duke na thënë: “Uluni, jeni armiq mos flisni, mos bëni e ku di unë shumë gjëra të tjera”.

Ju lutem, na lini të shprehim mendimin tonë në komision, ashtu si të jetë, me profesionistë, pa profesionistë, me eksperiencën që kemi, të flasim, të debatojmë dhe të jetë në interes të publikut. Nëse ju thoni, sepse ju si maxhorancë i keni votat dhe ne po ikim, vazhdojeni ju, bëjeni ju, sepse ju e keni hedhur si ide...

Ulsi Manja – Politikë doni të bëni këtu?

Adriatik Alimadhi – Jo, bëtë ju politikë.

Ulsi Manja – Unë jam shumë liberal në drejtimin e komisionit.

Adriatik Alimadhi – Zoti kryetar, bashkë kemi pasur dy-tre herë përplasje mendimesh. Në qoftë se ju e shihni si problem komunikimin dhe debatin në Komisionin e Ligjeve për të

hedhur ide dhe mendime, sinqerisht më duket pak e tepërt, por po ju them se sa më lirshëm ta lini komunikimin dhe debatin do të sjellim diçka të mirë dhe pozitive. Ju e vendosni vetë në fund të fundit, por në komunikim dhe në dhënien e mendimit duhet të jemi të barabartë.

Zoti Zeneli, nuk jemi te neni, sepse më duhet t'ju sqaroj diçka.

(Diskutime pa mikrofon)

Do t'jua jap unë fjalën pak më vonë.

E para, duhet të kuptohemi, sepse unë jam një nga propozuesit dhe përfaqësoj maxhorancën në drejtimin e këtij komisioni. Ne si maxhorancë kemi propozuar këtë (tregon diçka) dhe ky është qëndrimi ynë dhe nuk besoj se kemi shkelur ndonjë ligj, sepse edhe Kushtetuta dhe Rregullorja na e jep të drejtën ta propozojmë këtë nismë si deputet. Në komision, patjetër çdo koleg mund të bashkohet me këtë, mund të ketë propozim konkret për këtë, mund të ketë edhe paketë alternative të propozuar dhe unë natyrisht jam i detyruar t'i marr në shqyrtim dhe t'i diskutoj në këtë tryezë, por në fund t'ia nënshtroj edhe vendimmarrjes.

Por grupi i punës që ka punuar me Kodin Penal, zoti Alimadhi, këtu e kam ftesën për gjithë kolegët e komisionit, relatorja, zonja Xhina dhe kolegë deputetë të këtij komisioni, që kanë pasur interes për ta përmirësuar këtë paketë, kanë punuar me ditë të tëra, madje kanë qenë prezentë edhe në komisionet e tjera, sepse kanë qenë të pranishëm për dhënie mendimi, ku kanë dhënë mendime dhe sugjerime konkrete.

Unë e kam fjalën këtu për ekonomi kohe, sepse presupozohet që është ezauruar pjesa e sugjerimeve dhe e diskutimeve konkrete, por, gjithsesi, nëse ju thoni se ky nen duhet lënë i hapur, pasi një pjesë e kolegëve kërkojnë të bëjnë sugjerime dhe propozime konkrete, ne e kalojmë këtë nen dhe e lëmë të hapur dhe i rikthehemi për ta votuar në fund. Por unë nuk mund ta mbaj komisioni në nivel diskutimi dhe konsultimi, sikur jemi në mbledhjen e një grupi që po punon për ndryshimet e Kodit Penal, sepse ndryshe do të na kapë darka me një nen. Kështu që nëse për nenin 4, që ndryshon nenin 197, ka sugjerime dhe propozime konkrete që mund të merren në konsideratë deri sa ta votojmë ligjin në tërësi. E lëmë të hapur dhe kalojmë. Ndryshimet në Kodin Penal unë nuk i konsideroj çështje rutine, por shumë të rëndësishme, sepse zoti Alimadhi, edhe një herë po them se paketa e Kodit Penal nuk mund të kalojë në parlament nëse nuk e kemi votën tuaj. Është një ligj që kërkon 84 vota, por sa herë ka ndryshime në kode, patjetër do të ishte mirë që ne ta kishim gjithë mirëkuptimin dhe dakordësinë tuaj, jo vetëm në komision, por edhe me votë.

Kështu që unë këtë propozoj.

Adriatik Alimadhi- Unë ju mirëkuptoj ju, por unë nuk kam qenë pjesë e grupit të punës. Logjikën tuaj politike e kuptoj. Nëse ne e kalojmë nen për nen dhe ju më thoni ngrije ose ule dorën, nuk ka...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos ma kuptoni ashtu. Unë jam anëtar i këtij komisioni dhe unë ndiej një detyrim ndaj vetes sime për të votuar me ndërgjegje të plotë për një paragraf, për një nen të caktuar. Nëse ju thoni hajt ta mbyllim këtë, ta votojmë dhe pastaj ta kalojmë në fund fare, nuk e shoh procedurë të rregullt. Pra, unë nuk mund të votoj symbyllur për një paragraf dhe një nen të caktuar në lidhje me projektligjin që po kalojmë.

Faleminderit!

Ulsi Manja– Po, zoti Zeneli.

Alban Zeneli – Faleminderit!

Kjo pjesa e fundit që ju thatë më duket shumë interesante, sepse ne si grup i opozitës nuk kemi marrë pjesë në këtë debat, prandaj kemi sugjerimet tona. Nëse kemi mirëkuptimin tuaj, duhet edhe ne të japim mendimet tona. Por, që të jemi më të qartë, mund ta lëmë për më vonë ose nesër para se te shkojmë në seancë plenare.

Elena, me gjithë respektin që kam për ju, të lutem, ta mbaroj unë fjalën, pastaj flisni ju. Nuk ke pse të mërzhitesh, ju votat i keni dhe mund ta kaloni.

Unë kam një pyetje: ku është marrë modeli i këtij projektligji?

Ulsi Manja- Faleminderit!

Kjo paketë do të kalojë në seancë plenare në datën 20 qershor dhe do të duhet të mbyllet në komision sipas Rregullores.

Për nenin 197 ka qenë një variant i grupit nismëtar, ka një variant të propozuar nga relatorja, siç ka edhe një propozim tjetër nga Këshilli i Ministrave po për të shtuar një nen të ri, por që vjen pas nenit 197.

A keni ndonjë sugjerim teknik?

Pra, ka një propozim që të hiqet masa administrative dhe në titull të ketë një ndryshim, të hiqet lidhëza “dhe” dhe të zëvendësohet me “ose” dhe të shtohet fjala “ose ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin”. Deri tani jemi në këto propozime konkrete.

Zoti Pratola, a keni ndonjë gjë për të shtuar?

Gianluigi Pratola - Shqetësimi i parë ka të bëjë me paragrafin e parë ku është marrë më parë masa administrative. Kjo është një ndër fjalitë, që më shqetëson për arsye se mbase mund të sjellë konfondime në aplikimin e këtij neni në lidhje me paqartësinë kur është marrë

masa administrative dhe pastaj dënohet me burgim nga 1 deri në 3 vjet. Mbase, do të duhet një studim më i mirë i këtij paragrafi për ta parë në lidhje edhe me ligjin NR. 155/2015 për lotaritë dhe për të parë edhe praktika të tjera të vendeve të tjera të BE-së, jo domosdoshmërisht për t'i marrë siç i kanë, por për të parë si i kanë nenet e ngjashme dhe si e rregullojnë aktivitetin e lojërave të paligjshme për të kaluar te pjesa tjetër.

Pjesëmarrja në lojërat e fatit, është çështja e dytë, e cila nuk është mjaft e qartë në këtë nen. Siç e diskutuat, bëhet fjalë që janë përjashtuar totalisht, por kjo nuk është shumë e qartë. Në qoftë se janë përjashtuar, a është e drejtë një gjë e tillë? Mos kjo gjë mund të japë një opinion negativ në kuptimin që përjashtohen të gjithë ata që marrin pjesë në lojërat e fatit? Mos duhet të rregullohet marrja pjesë e tyre? Për shembull, disa modele si Italia dhe Austria që flasin për pjesëmarrësit në lojërat e fatit dhe e përcaktojnë si faj, domethënë marrin pjesë me anë të neglizhencës, në mënyrë të qëllimshme, ose jo. Domethënë, vendosja në dispozitë edhe “pjesëmarrësve” dhe “cilësimi”...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky ishte shqetësimi tjetër që duhet konsideruar në këtë pikë.

Ulsi Manja – Zonja Xhina, kush e propozoi shtimin e fjalisë “kur më parë është marrë masë administrative” te ky nen? Ka mundësi të ma sqaroni?

Elena Xhina – Propozimi për të vendosur fjalinë “kur më parë është marrë masë administrative”, ka qenë i përfaqësuesit të EURALIUS-it, Ildirit, pasi mendoi që nuk mund të penalizonim këtë organizim dhe ushtrim të veprimtarive të lojërave të fatit dhe ta bënim vepër penale.

Ne e morëm në konsideratë dhe e paraqitëm.

Ulsi Manja – Këtë nen do ta lëmë të hapur. I quaj me vend dy sugjerimet që u bënë: titulli, heqja e listës dhe shtimi i togfjalëshit “ushtrimi i veprimtarive”, por do të marrim një opinion dhe do ta konsultojmë me faktin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk do ta hedhim në votim tani, por do ta lëmë të hapur, sepse, duke qenë një nga nismëtarët e këtij neni, disa gjëra janë ndryshuar nga propozuesit nga varianti që kanë propozuar. Nuk më përputhet me qëllimin me të cilin e kemi depozituar, kështu që do ta lëmë hapur.

Ka një propozim përsëri për nenin 197.

Klotilda Bushka - Zonja Xhina, mos ndoshta doni të flisni ju për nenin 197, “a”, për shtesën që kërkon Këshilli i Ministrave?

Ulsi Manja – Mund të thoni që ka propozim për këtë nen.

Klotilda Bushka – Relatorja dhe grupi i punës e kanë çuar për mendim projektligjin në institucionin e Kryeministrit dhe në disa ministri. Nga Këshilli i Ministrave kanë ardhur sugjerime për shtesë të disa neneve ose për riformulime. Një prej tyre është edhe një ndryshim pas nenit 197, ku propozohet të ndryshohet paragrafi i parë i nenit 197 “a”, si më poshtë vijon: “Kryerja e veprimeve ose mosveprimeve për paracaktimin e rezultateve në garat sportive kombëtare dhe ndërkombëtare, në kundërshtim me parimet e lojës së ndershme, dënohet me burgim nga 1 deri në 3 vjet”.

Ky është propozimi.

Ulsi Manja – Pra, ka një propozim për shtimin e një paragrafi 197/ “a”, që u referohet garave sportive, që janë të lejuara në ligjin e...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bëhet fjalë për rezultatin e ndeshjeve, paracaktimin e tyre. Gjithsesi, do t’ua kalojmë propozimin e ardhur nga...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është në Kodin Penal.

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Neni 197/ “a” është pjesë e Kodit Penal ekzistues. Ndryshimet që ka sjellë qeveria konsistojnë vetëm në masën e dënimit, ka qenë kundërvajtje penale dhe duan ta bëjnë vepër penale, duke e dënuar nga 1 deri në 3 vjet. Vetëm këtu konsiston ndryshimi.

Ulsi Manja – Dakord. Atëherë do t’i kthehemi në fund.

Kalojmë te neni 5, që ndryshon nenin 201.

Elena Xhina – Për sa i përket nenit 5, që ndryshon nenin 201, qëllimi si i deputetëve nismëtarë, por edhe yni, ka qenë transpozimi sa më i plotë i direktivës si një nga kërkesat e Bashkimit Europian për ta transpozuar në Kodin Penal. Në riformulim janë marrë parasysh si propozimet e Komisionit të Veprimtarive Prodhuese, po ashtu edhe propozimet e Shërbimit të Përafrimit të Legjislacionit të Kuvendit.

Para deputetëve sot, paraqitet ripropozimi ynë për riformulim, i cili besoj se nuk do të ndryshojë qëllimin tuaj si nismëtar.

Nuk e di nëse duhet ta lexoj apo jo, por propozoj që duke filluar me paragrafin e parë të tekstit, që është “ndotja e ajrit, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, ndotja në sipërfaqe apo në thellësi të tokës”, të shtojmë fjalët “dëmtim i rëndë në kafshë apo në bimë”, e vazhdojmë me të tjerat më pas.

Ulsi Manja – Pra, jemi te varianti i propozuar ku thuhet: “Ndotja e ajrit dhe e tokës”.

Elena Xhina – Varianti i ri i propozuar nga ne...

Ulsi Manja –Ju lutem, e kam variantin tuaj. Neni 201 ka qenë: “Ndotja e ajrit dhe e tokës”, propozohet të jetë “Ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës”. Është dakordësuar ky nen, meqenëse është transpozim direktivash të BE-së?

Elena Xhina – Është dakordësuar me EURALIUS-in, gjithashtu me Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit të Kuvendit, me Ministrinë e Mjedisit, pra me të gjithë grupin e punës.

Ulsi Manja –Dakord.

Elena Xhina – Dua të shtoj diçka nëse më lejoni: në propozimet e tyre ka qenë si kërkesë, meqenëse e kërkonte direktiva, që të “shkaktimi i pasojës”, të shtoheshin “kur ka shkaktuar dëmtim, ose mund të shkaktojë dëmtim”. Këtë e kemi lënë të hapur si diskutim. Sot nuk e kam paraqitur si propozim, pasi fillimisht, meqenëse nuk ishte gjuha e Kodit Penal, u mendua që nuk duhet të ishte në dispozitë, por nga këmbëngulja që pati edhe Shërbimi i Përafrimit të Legjislacionit, edhe vetë zotëria mund ta sqarojë, mendoj se duhet të jetë të dispozitat e reja që transpozojnë direktivën. Por le t’i marrim një mendim.

Ulsi Manja – Ju lutem, shkurtimisht.

Dedë Kasneci – Faleminderit, zoti kryetar!

Quhem Dedë Kasneci, jam drejtor i Shërbimit të Përafrimit të Legjislacionit në Kuvend. Ne kemi paraqitur një opinion ligjor, duke qenë se ky ligj synonte përafrimin, ku kemi krahasuar versionin e propozuar me versionin e punuar nga grupi i punës. Pra, është përafëruar shumë mirë, por përsëri mungon elementi i lidhjes shkakësore. Deputetja Xhina më tha se ky aspekt është diskutuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një ndër argumentet është ky: Shqipëria ka detyrimin, në bazë të nenit 70 të MSA-së, që të gjithë legjislacionin aktual dhe të ardhshëm ta përafërojë me legjislacionin e Bashkimit Europian.

Tani, kjo është direktiva për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet veprave penale, por elementi i lidhjes shkakësore mungon në versionin e propozuar. Konkreisht, neni 201 përafëron nenin 3/a të direktivës 2008/99, por mungon elementi i lidhjes shkakësore: “*which cause or is likely to cause*”, pra që shkakton ose mund të shkaktojë.

Në vlerësimin tonë, zoti kryetar, pra jo vetëm se e parashikon direktiva, por është në përputhje edhe me pjesën e përgjithshme të Kodit Penal dhe me dispozitën 230, që parashikon veprat penale në fushën e terrorizmit.

Në nenin 13 “Lidhja shkakësore”, që i përket pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, parashikohet: “Askush nuk ka përgjegjësi penale kur ndërmjet veprimit ose mosveprimit të tij

dhe pasojave apo mundësisë së ardhjes së tyre mungon lidhja shkakësore”. Pra, pjesa e përgjithshme e Kodit Penal e parashikon mundësinë e ardhjes së pasojave.

Në nenin 230 të Kodit Penal, ku parashikohen veprat penale për qëllime terroriste, parashikohet si përgjegjësi penale jo vetëm kur ka ardhur pasoja, por edhe kur është krijuar rreziku dhe mundësia e ardhjes së saj.

Ulsi Manja – Çdo vepër penale e kryer me dashje ka edhe tentativën brenda.

Dedë Kasneci – Po.

Ulsi Manja – Tentativa është mundësia e ardhjes së pasojave dhe kjo është doktrinë e pjesës së përgjithshme, Dedë!

Dedë Kasneci – Po, pra.

Ulsi Manja – I di këto zoti Luli, aq sa ka harruar kur i ka nisur!

Dedë Kasneci – Pra, sugjerimi është që të shtohet...

Edhe Kodi italian Penal, nëse mundem, e parashikon.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, veprat penale në fushën e mjedisit, jo vetëm kur ka ardhur pasoja, por edhe kur është krijuar rreziku që...

Ulsi Manja – Dakord, edhe kur vjen mundësia e ardhjes së pasojës.

Dedë Kasneci – Në rregull. Faleminderit!

Ulsi Manja – Shumë faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Luli, keni dhënë opinion ju, si prokurori, për këtë nen?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kujtim Luli – Kemi qenë pjesë e grupit të punës dhe jemi shprehur dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zonja Xhina?

Elena Xhina – Zoti kryetar, unë mendoj se, duke e marrë në konsideratë edhe komentimin e zotit Kasneci lidhur me shprehjen “mund të shkaktojë”, duke shtuar edhe fjalinë që unë thashë: “dëmtimi i rëndë në kafshë ose në bimë”, mund ta hedhim në votim dispozitën.

Ulsi Manja – Avokati i Popullit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ardian Nezha – ...legjislative, në nenin ekzistues 201 thuhet: “Kur vepra nuk përbën kundërvajtje administrative, përbën kundërvajtje penale”, por në riformulim kjo është hequr fare. Pra, po të kemi parasysh ligjin organik, që rregullon këto çështje, apo aktet nënligjore, të

cilat përcaktojnë normat e shkarkimit në tokë, në ujë apo në ajër, mendojmë se do të ishte më e qartë nëse lihet siç ka qenë pjesa kur vepra nuk përbën kundërvajtje administrative.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Misioni EURALIUS, meqenëse jemi në transpozimin e një direktive të BE-së, e ka dhënë opinionin lidhur me të gjitha nenet e propozuara, që kanë të bëjnë me krimet mjedisore?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gian Luigi Pratola – Po, janë dhënë opinionet e EURALIUS-it për sa u përket dispozitave, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit. Po ashtu, shqetësimi ynë, siç e tha edhe zotëria, për transpozimin e një direktive është e nevojshme të peshohet se cila fjalë e direktivës... Sepse, pastaj, kur të bëhet tabela e përputhshmërisë, do të jetë e nevojshme të tregohet se janë të transpozuara posaçërisht siç i ka parashikuar direktiva. Pra, shprehja “ka shkaktuar” ose “ka mundësi të shkaktojë”, ndoshta, duhet marrë në konsideratë.

Ulsi Manja – Jam dakord.

Atëherë, e hedhim në votë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ka diskutim, por siç është direktiva!

Merreni direktivën dhe, duke qenë se keni thënë që është transpozim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord pra, dakord. Kur të bëhet tabela e përafrimit në fund, sepse për këtë kapitull dua tabelë përafrimi për kolegët e mi deputetë, të cilët do ta votojnë në seancë plenare këtë paketë ndryshimesh në Kodin Penal, pra pjesën që është transpozim direktive e dua me tabelë përputhshmërie, madje të tregohet se ku përputhet dhe ku jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është dakord me nenin 5, që ndryshon nenin 201, sipas variantit të propozuar? Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 201/a. Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Lidhur me nenin 6, që propozon të shtohet neni 201/a, nga grupi i punës neni 201/a është parë jo i nevojshëm për të qenë në draft, pasi më vonë ky nen e gjen veten në dispozita të tjera dhe ngre një problematikë të gjerë, e cila nuk përcakton shprehimisht se për çfarë figure të veprës penale bëhet fjalë. Në këtë mënyrë kemi propozuar që neni 201/a të mos jetë pjesë e draftit, pasi sqarohet në dispozitat përkatëse.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Kush është dakord që neni 6, i cili shton nenin 201/a “Shkaktimi i fatkeqësive mjedisore”, të hiqet nga teksti? Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet. Pra, hiqet neni 6.

Kalojmë te neni tjetër që shtohet, te neni 201/b “Menaxhimi i mbetjeve”.

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Në nenin 201/b janë bërë disa saktësime lidhur me terminologjinë e përdorur nga direktiva. Është bërë një rregullim i renditjes së paragrafëve sipas rëndësisë së veprës, duke ndarë në dy paragrafë të veçantë dëmtimin e rëndë të shëndetit ose vdekjen. Gjithashtu, propozoj të shtohet këtu togfjalëshi “mund të shkaktojë”, si kërkesë e direktivës.

Ulsi Manja – Biem dakord me nenin 201/b “Menaxhimi i mbetjeve”? Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 201/b.

Kalojmë te neni 201/c “Transportimi i mbetjeve”. Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Në nenin 201/c janë bërë përsëri disa saktësime për terminologjinë e përdorur nga direktiva. Propozohet të ketë një ndryshim në masën e dënimit, duke e hequr minimumin e dënimit me burgim, pasi është me gjobë ose me burgim nga dy deri në pesë, ne kemi thënë deri në pesë, meqenëse pjesë e kësaj është edhe gjoba.

Ulsi Manja – Po.

Elena Xhina – Në fakt, këtu ka edhe një propozim të grupeve të interesit, të cilët kërkojnë që të vendoset togfjalëshi “Nëse më parë është marrë një masë administrative”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

Elena Xhina – Unë duhet ta them, pastaj si ta çmoni ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zonja Xhina, ramë dakord që do të jetë me tabelë përputhshmërie me direktivën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse propozimet dhe sugjerimet e grupeve të interesit nuk përshtaten me direktivën, shumë faleminderit për bashkëpunimin dhe sugjerimin në diskutimin e kësaj pakete, por këtu jemi në direktivë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Hedhim në votim nenin 201/c.

Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 201/d.

Aktivitetet e rrezikshme.

Elena Xhina – Në nenin 201/d janë bërë disa saktësime për terminologjinë e përdorur nga direktiva, një rregullim i renditjes së paragrafëve sipas rëndësisë së veprës, si dhe kemi hequr dënimin me gjobë në paragrafin e parë, pasi kemi menduar që është një vepër penale e rrezikshme dhe me pasoja. Nëse ka mendime të tjera, jemi të hapur. Gjithashtu, duhet të shtohet togfjalëshi “kur mund të shkaktojë”.

Ulsi Manja – Pra, edhe neni 201/d është motamo direktivë.

Kush është dakord me nenin 201/d? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 201/e.

Materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme.

Elena Xhina – Edhe në këtë nen janë bërë disa saktësime të terminologjisë që kërkon direktiva. Është bërë një rregullim i renditjes së paragrafëve sipas dëmtimeve dhe pasojave që sjell vepra. Gjithashtu, kërkojmë të shtohet togfjalëshi “mund të shkaktojë”, që kërkon direktiva.

Ulsi Manja – Kush dakord me nenin 201/e?

Po, zoti Luli.

Kujtim Luli – Te paragrafi i parë, masa e dënimit, pasi thuhet “gjobë”, thuhet edhe “me burgim deri në 2 vjet”. Sugjeroj të hiqet termi “gjobë” dhe të ngelet vetëm “deri në 2 vjet”.

Kush është dakord me nenin 201/e, me sugjerimin e bërë? Kundër? 1 votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7, që ndryshon nenin 202.

Elena Xhina – Neni 202 ekzistues i Kodit Penal ndryshon në tërësi, sepse transportimi i mbetjeve toksike tashmë është parashikuar në nenin 201/e.

Kështu që, neni 202 flet për dëmtimin e specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër. Ne propozojmë që ky nen të ndahet në dy nene, sepse njëri flet për dëmtimin e specieve, kurse tjetri për tregtimin. Pra, meqenëse janë dy gjëra të ndryshme ...

Ulsi Manja – Dakord, por propozoj ndarjen.

Elena Xhina – Neni 202 titullohet: “Dëmtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër”, ose sipas përmbajtjes që ju keni përpara. Kurse titulli i nenit i ri është: “Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër”.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 7, që ndryshon nenin 202, me titull “Dëmtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër? Kundër? 1 votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord që të shtohet një nen i ri, “Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 8, që ndryshon nenin 202/a.

Elena Xhina – Këtu shtohet neni 202/a. Në krahasim me variantin e paraqitur nga deputetët nismëtarë, kemi ndryshim në titull. Ka qenë “habitatet në zonat e mbrojtura” dhe është bërë “dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore”. Është ndryshuar riformulimi për shkak të teknikës legjislative. Gjithashtu, masa e dënimit ka qenë me gjobë ose burgim nga 2-5 vjet, kurse ne kemi propozuar të jetë me gjobë ose burgim deri në 5 vjet.

Ulsi Manja - Është reflektuar ajo që tha zoti Luli pak më parë.

Kush është dakord me nenin 202/a, “Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura”? Kundër? 1 votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 9, që ndryshon nenin 203.

Elena Xhina - Në nenin 203 kemi propozuar që të hiqet dënimi me gjobë, pasi mendojmë se është një vepër me rrezikshmëri të rëndë dhe të vihet dënimi nga 1- 7 vjet burg dhe jo 3-7 vjet.

(Mungesë incizimi)

Propozohet të shtohet një nen i ri, 207/1. Ne kemi sjellë riformulimin e tij, që mendojmë se detajon dhe është sipas rregullave të teknikës legjislative. Propozojmë të votohet sipas variantit të paraqitur.

Ulsi Manja - Pra, neni 207 ...

Kujtim Luli – Po t’i referohemi ligjit organik, që unë e kam trajtuar edhe në seancën e mëparshme, në vlerësimin tim jo të gjitha shkeljet duhet të përbëjnë vepër penale. Ajo shkelje e rregullave që përbën vepër penale duhet të ngelet ajo që rrezikon publikun kur qeni pa mbajtësen ...

Pra, duhet hequr formulimi “shkelja e rregullave” dhe duhet riformuluar ky nen.

Ulsi Manja – Keni ndonjë riformulim?

Kujtim Luli – Po, e kemi paraqitur në një propozim në komisionin e mëparshëm.

Mund të themi “Braktisja e kafshës së shoqërimit kur ka shkaktuar ...”.

Ulsi Manja – Ka një propozim nga relatorja që ta lëmë hapur këtë nen.

Elena Xhina – Atëherë, meqenëse ka sugjerime për këtë dispozitë, mendoj që ta lëmë të hapur këtë nen.

Ulsi Manja – Ju lutem këshilltarëve të mbajnë shënim dispozitat që kemi lënë të hapura, me qëllim që përpara votimit në tërësi t’u rikthehemi me formulimet përkatëse.

Kalojmë te neni 11.

Elena Xhina – Ne nuk kemi propozime për këtë dispozitë, por propozojmë të votohet sipas variantit që kanë paraqitur deputetët nismëtarë.

Ulsi Manja – Pra, kemi kaluar te neni 237, “Goditjet për shkak të detyrës”.

Fjalën e ka kërkuar zëvendësministri i Brendshëm, zoti Hodaj për të bërë një propozim konkret.

Julian Hodaj – I nderuar kryetar, faleminderit!

Ne kemi propozuar edhe në grupin e punës një risistemim të neneve 236 dhe 237 të Kodit Penal. Në nenin 236, ku flitet për goditjet ose për vepra të tjera dhune që i bëhen punonjësit që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik, të modifikohet sipas shembullit të nenit 316, që është: kundërshtimi dhe goditja e gjyqtarit. Propozuam që në këtë nen të përfshihej edhe kundërshtimi, edhe goditja ndaj punonjësit të policisë, duke hequr paragrafin e dytë të nenit vijues 237, që është për punonjësin e policisë.

Në nenin 236 të vihet edhe kundërshtimi, edhe goditja ndaj punonjësit të policisë. Theksoj se nuk po flas për punonjësit të policisë të rendit publik, pasi besoj se çdo punonjës policie ka nevojë për këtë lloj mbrojtjeje.

Kemi një formulim të gatshëm, që është dërguar me *e-mail*.

Elena Xhina – Zoti kryetar, është bërë ky diskutim në grupin e punës, por dispozita e re që ka ndryshuar, është bërë për t’i dhënë një mbrojtje specifike në mënyrë të veçantë disa grupeve subjektesh. Mendoj se klasifikimi është në të njëjtën vepër penale bën një mbrojtje më të mirë të tyre. Nuk e kemi prekur nenin 236, sepse flet pikërisht për kundërshtimin dhe kjo është një dispozitë specifike për goditjen dhe ne mendojmë se e realizon qëllimin e dispozitës.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Xhina!

Urdhëroni, zoti Luli!

Kujtim Luli – Në lidhje me këtë dispozitë, mbrojtja e posaçme që i bëhet punonjësit të policisë, është edhe në nenin 235, edhe te neni 236. Në mënyrë të posaçme paragrafi i dytë i këtij neni parashikon: “Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose duke ushtruar dhunë fizike ...” Në praktikën gjyqësore, por edhe në doktrinën që interpreton këtë paragraf, në pjesën e

kundërshtimit me dhunë, përfshihet edhe goditja. Në vlerësimin tonë, kjo është përfshirë te paragrafi 2. Po të shohim sanksionin ai është më i ashpër sesa ky që propozohet se në ligjin ekzistues parashikohet dënim me gjobë ose me burgim deri në shtatë vjet.

Ndoshta duhet hequr gjoba në paragrafin e dytë. Po e bëtë këtë, keni përmbushur edhe qëllimin që keni me iniciativën ligjberëse.

Ulsi Manja – Zoti Hodaj!

Julian Hodaj – A ta lexoj riformulimin e propozuar dhe më pas të mbetet në vlerësimin e komisionit?

Ulsi Manja – Po.

Julian Hodaj – Kemi propozuar: “Kundërshtimi që i bëhet punonjësit të policisë me qëllim për ta penguar në kryerjen e detyrës sipas ligjit apo për shkak të saj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 1 vit.” Ky ishte paragrafi i parë.

Paragrafi i dytë është : “Kundërshtimi me dhunë dhe vepra të tjera dhune që i bëhen punonjësit të policisë gjatë ushtrimit të detyrës, për ta penguar atë në kryerjen e detyrës apo për shkak të saj, dënohet me burg nga 1-7 vjet”. Sipas mendimit tonë ky formulim përmbush edhe nevojat e nenit 236 ekzistues, edhe ato të nenit 237.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Ne në fakt si pjesë të paketës sonë nuk e kemi pasur fare nenin 236, nuk e kemi prekur atë, sepse qëllimi ynë ka qenë të fokusohemi vetëm te goditja për shkak të detyrës, pra vetëm te neni 237. Ne nuk e kemi parë në këndvështrimin që të reflektohet te neni 236 edhe kundërshtimi, edhe goditja, sepse kemi dashur që këtë ta nënvizojmë te neni 237.

Urdhëroni, zoti Xhafaj!

Fatmir Xhafaj – Unë besoj se propozimi është me interes dhe ne duhet të shohim se çfarë ndodh më shumë zakonisht, goditja apo kundërshtimi. Ky është një fenomen më i përhapur dhe duhet të ketë një reagim më të fokusuar nga ne. Pastaj, a mbetet dispozita siç është apo ka nevojë për t’u riparë, kjo është një çështje tjetër.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Luli!

Kujtim Luli – Referuar praktikës gjyqësore dhe praktikës së ushtrimit të ndjekjes penale, në kundërshtimin me dhunë përfshihet edhe goditja. Tashmë praktika gjyqësore e ka zgjidhur edhe interpretimin e fjalës “kundërshtim me dhunë”. Në vlerësimin tonë ky paragraf e përmbush atë që ligjberësi ka si qëllim për ta përmirësuar. Nëse do ta lëmë edhe një paragraf te neni i ri i propozuar, ligjzbatuesi nuk e di se cilën dispozitë duhet të aplikojë.

Nuk mund të shkosh në një dispozitë të projektligji. Nëse ne do të kemi për zbatim këto 2 dispozita, cilës duhet t'i referohesh? Njëra dispozitë parashikon burg deri në 5 vjet, dhe tjetra parashikon gjobë deri në 7 vjet.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Luli!

Zoti Hyseni!

Alket Hyseni – Duhet të bëjmë dallimin. E lëmë qëllimin që kemi politikisht se ju e shpjeguat qartë që është për të dhënë një mbrojtje të veçantë.

Kemi dy momente të ndryshme. Dispozita e parë e mbron punonjësën e policisë kur është në punë, ndërsa dispozita e dytë e mbron atë edhe jashtë detyrës. Shikoni termin: “me qëllim për ta penguar atë në kryerjen e detyrës sipas ligjit”.

Çfarë ndodh me një punonjës, i cili mbron detyrën dhe goditet për shkak të punës, të rrugës për në shtëpi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e ke. Shikoje! Pse duhet patjetër ta ndryshojmë tërësisht këtë? Ky është një moment tjetër, që do një mbrojtje të veçantë të dispozitës që mbron në tërësi zyrtarët duhet që të jetë edhe punonjësi si subjekt i veçantë, duke i dhënë një mbrojtje edhe më të madhe në praktikë. Prandaj zbatuesi i ligjit ta ndajë në praktikë nisur nga momenti, nëse është në detyrë dhe jashtë saj. Dispozita e dytë është vetëm nëse klasifikohet si kundërshtim i punonjësit.

Nëse është në krye të detyrës është te paragrafi i parë. Unë nuk e kuptoj se ku është vështirësia këtu? Nuk ka ndonjë të keqe këtu nëse e përsërit. Keq është kur mungon. Përsëritja është nëna e dijes.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Që të jemi të qartë, Kodi Penal ekzistues e ka kundërshtimin e punonjësit të policisë të rendit publik me dy paragrafë, siç ka edhe dispozitën për goditjen për shkak të detyrës, ku nuk ka qenë e theksuar mbrojtja e posaçme për punonjësën e policisë, për profesionistin shëndetësor dhe për personat e zgjedhur, por e ka pasur në përgjithësi për të gjithë kategorinë e subjekteve në ushtrimin e detyrës (neni 237). Te ky nen mund të futet edhe një arsimtar në ushtrimin e detyrës, kur goditet. Ne në fakt e kemi parë të arsyeshme që te neni 237 të jetë mbrojtja e posaçme që jepet për punonjësën e policisë, për profesionistin shëndetësor dhe për personat e zgjedhur. Po të ishte kështu, ne e kishim bërë te neni 236 dhe thoshim: edhe kur është goditur. E kemi pasur si qëllim në vetvete për ta bërë këtë te neni 237.

Unë kërkoj një mendim: a qëndron nga pikëpamja e strukturës dhe e formulimit përmbajtja e nenit 237, që propozojmë ne? A krijon probleme në zbatimin praktik? Dispozita 236 “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik” thotë: “Po kjo vepër, kur kryhet në

bashkëpunim ose duke ushtruar dhunë fizike, dënohet me gjobë ose burgim deri në 7 vjet”. Ndërkohë që ne themi: “...kur kjo vepër, goditja apo vepra të tjera dhune, ndaj punonjësit që kryhen një detyrë shtetërore apo shërbim publik”, pastaj themi: “Po kjo vepër, kur kryhet ndaj punonjësit e policisë për shkak të veprimtarisë së tij dhe kur cilësitë e personit janë të dukshme ose të njohura, dënohet me burgim nga 1 deri në 5 vjet”. Pra, është krejtësisht tjetër qëllimi.

Urdhëroni, zonja Xhina!

Elena Xhina - Me sqarimet që bëri edhe Alketi, mendoj se del më se e qartë. Dispozita 236 cilëson momentin kur punonjësi i policisë është duke kryer një detyrë funksionale të tij. Me qëllim që ta pengojë atë të kryejë detyrën, bëhet kundërshtimi. Në paragrafin 2, që është rrethana rënduese, qëllimi është përsëri i njëjtë për ta penguar të kryejë detyrën. Në rastin konkret, propozimi, që ju keni sjellë, dhe ne nuk e kemi ndryshuar, ka të bëjë me faktin se kjo mbrojtje e tejkalon momentin e kryerjes së detyrës. Pra, nuk është qëllimi për ta penguar për të kryer detyrën, por është për shkak të detyrës.

Ulsi Manja – Në rregull.

A jeni kakord me nenin 237? A ka sugjerime të tjera? Nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Juli kërkon që elementi “dhunë” të hiqet dhe të shkrihet bashkë me 237, në qoftë se nuk gaboj?

Julian Hodaj – Ne kemi marrë model nenin 316, që është “Mbrojtja e gjyqtarit”, që, për mendimin tonë, i ezauron të gjitha aspektet, që ju sapo përmendët. Të njëjtën gjë po propozojmë ta bëjmë edhe me punonjësin e policisë, sepse besojmë se është një kategori që meriton një mbrojtje të veçantë dhe ndryshe nga të gjithë ata që mund të ushtrorjnë funksione publike. Te formulimi që kemi paraqitur, të cilin sapo ua lexova, besojmë se mbulon edhe aspektin gjatë ushtrimit, në momentin e ushtrimit të detyrës, për shkak të ushtrimit të detyrës, dhe i mbulon të gjitha këto aspekte që ju sapo i ngritët. Sistemi në një nen të vetëm, besoj se ndihmon edhe në zbatimin në praktikë.

Ulsi Manja – Neni 316 “Kundërshtimi dhe goditja e gjyqtarit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, pse Kodi Penal ka ruajtur këtë strukturë për kundërshtimin e punonjësit të policisë dhe goditjen...”? Ideja është kjo: ne nuk kemi ndërhyrë për ta ndryshuar, t’i thua të bashkohet neni 236 me paragrafin 2 të nenit 237 që propozojmë ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju mendoni se qëllimi plotësohet me këtë formulim që bëni ju? Ne qëllimin e kemi të mirë.

Julian Hodaj – Edhe ne qëllimin e kemi të mirë. Nëse do të mendonim që objektivi nuk arrihet, nuk do ta propozonim.

Ulsi Manja – Ju si mendoni: a arrihet ky qëllim, nëse i bashkojmë dhe marrim për analogji nenin 316?

Julian Hodaj – Mora për analogji nenin 316 për shkak të teknikës legislative të përdorur dhe të mënyrës se si është hartuar neni. Ne besojmë se arrin më mirë objektivin se sa formulimin në këto 2 nene të ndryshme. Pastaj, gjithmonë tagrin e ka komisioni për ta vlerësuar.

Ulsi Manja – Po në variantin, që e kemi bërë ne, realizohet ajo që kemi dashur të shprehim me nenin 237?

Zoti Luli, në praktikë, a krijon probleme kjo dispozitë?

Kujtim Luli – Ashtu siç e thashë, mund të krijojë, sepse tek interpretimi, që i ka bërë deri tani ligjzbatuesi, e ka përdorur. Domethënë, edhe kur është goditur punonjësi i policisë, kanë shkuar në paragrafin 2 të nenit 236 që është mbrojtja e posaçme në këtë nen. Në qoftë se duhet qartësuar, duhet të bëhet me formulimin e ri, që solli zëvendësministri i Brendshëm.

Ulsi Manja – Urdhëroni, zoti Hyseni!

Alket Hyseni – E thashë neni 236 nuk e zgjidh fare atë që duam të zgjidhim ne. Diskutimi është: ta bëjmë kështu siç e kemi ne, apo me formulimin e ri të ministrit? Ne jemi komision përgjegjës, e fusim në votim dhe vazhdojmë.

Ulsi Manja – Nuk është qëllimi aty.

Alket Hyseni – Rëndësi ka që qëllimi i të dyja palëve është i njëjtë. Atë do edhe policia, atë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk lodhem.

I nderuar zoti kryetar, kemi një qëllim politik. Duhet ta bëjmë të qartë pse e kemi! Ne duam që në këtë grup të jetë patjetër policia.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Politika penale sigurohet nëpërmjet politikës. Ky është mekanizmi i vetëm që njeh ky sistem. Po të ishte, nuk angazhoheshim në politikë. Unë mendoj se ne e zgjidhim qëllimin për t'i dhënë mbrojtje të veçantë, më të zgjeruar se ajo që ka, kur është duke kryer detyrën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Edhe kështu siç e kemi, nuk krijon asnjë lloj problemi. *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Alket Hyseni – Është në dinamikë, është në kryerjen e detyrës shtetërore. Kjo që themi ne, është edhe përtej kësaj. Mund të jetë përpara detyrës, ai e pengon ose pas detyrës, ose gjatë detyrës, por gjithnjë për shkak të detyrës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Konkurrimi i veprave nuk është rasti i parë. Konkurrimi i veprave nuk e bën veprën të pazbatueshme i jep mundësi ligjzbatuesit që të zgjedhë dispozitën. *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 237, sipas variantit të propozuar?

Kush është dakord me nenin 11, që ndryshon nenin 237, sipas propozimit që sjell relatorja? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 12, që ndryshon nenin 238 “Kanosja për shkak të detyrës”, këtu është ruajtur e njëjta linjë.

Urdhëroni, zonja Xhina!

Elena Xhina - Në nenin 238, i cili ndryshohet me anë të nenit 12 të draftit, ne propozojmë që të shtohet një paragraf i fundit, i cili i përmbahet së njëjtës logjikë të nenit 237: “Kur kjo vepër kryhet në mjediset e institucionit, ku personi ushtron detyra shtetërore funksionin apo shërbimin publik, dënohet me burgim nga 1 deri në 3 vjet”.

Ulsi Manja – Në rregull.

E hedhim në votim nenin 238.

Kush është dakord me nenin 238, sipas variantit të relatores? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 238.

Kalojmë te neni 13, ku propozohet që pas nenit 238 të shtohet një nen, neni 238/a “Pengimi i ushtrimit të detyrës së profesionistit shëndetësor”.

Elena Xhina – Edhe kjo ka qenë një dispozitë e diskutuar goxha nga grupi i punës, por, përfundimisht, është parë me vend që të lihet varianti i propozuar nga Komisioni i Shëndetësisë me riformulimin që keni në tavolinë.

Ulsi Manja – Pra: “Pengimi i ushtrimit të detyrës së profesionistit shëndetësor”, propozohet që të thuhet: “Pengimi i ushtrimit të detyrës së profesionistit shëndetësor në mjediset e institucionet të kujdesit shëndetësor përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë”.

Elena Xhina – Për t’u paraprirë diskutimeve që do të bëhen nga prokuroria, dua t’ju them se në diskutimin që është bërë me grupin e punës është menduar që kjo dispozitë është ezauruar në nenin 235 të Kodit Penal. Në diskutimet që janë bërë me deputetët nismëtarë, me

grupet e tjera të interesit dhe me Komisionin e Shëndetësisë është kërkuar një mbrojtje e posaçme për profesionistët shëndetësorë. Duke marrë parasysh këto dy balanca dhe duke ngulur përsëri para konkurrimit të veprave penale, e sollëm këtë propozim. Kështu që ju ftojme ta votojmë.

Ulsi Manja – Unë për këtë ju pyeta.

Alket Hyseni – Ka një moment që dispozita e propozuar është më pak penalizuese se dispozita e propozuar dhe është më pak penalizuese se dispozita që i referohet neni 235 dhe, nëse do t'i japim mbrojtje të veçantë, këtu e lëmë vetëm me gjobë. Çfarë mbrojtjeje të veçantë i japim ne kur këtu masa është me gjobë dhe burgim deri në 6 muaj?! Ne nuk i japim mbrojtje të veçantë, por e zbusim atë. Pra, për këtë kategori punonjësish shtetërorë, në vend që ne t'i japim mbrojtje të veçantë, ne zbusim dispozitën aktuale, sepse ndonjëherë komisionet që nuk janë njohës të mirë të ligjit, në vend që të heqin vetullën, të nxjerrin sytë.

Ulsi Manja – Zonja Xhina, cilin variant do të votojmë?!

Elena Xhina – Unë sot kam sjell variantin e Komisionit të Shëndetësisë “Pengimi i ushtrimit të detyrës së profesionistit shëndetësor” “Pengimi i ushtrimit të detyrës së profesionistit shëndetësor në mjediset e institucionit të kujdesit shëndetësor përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë”.

Ulsi Manja – Pse nuk e shpjegoni se cili ka qenë qëllimi i kësaj dispozite?! Qëllimi i kësaj dispozite ka qenë që të marrë në mbrojtje profesionistin shëndetësor në sallën e operacionit dhe në reanimacion. Pra, mjekët kanë ngritur një shqetësim që gjatë ushtrimit të detyrës, familjarët e personave të aksidentuar, apo të gjymtuar me armë zjarri futen në reanimacion dhe i pengojnë ata në ushtrimin e detyrës. Ata na kanë kërkuar që në Kodin Penal t'i jepet një zgjidhje këtij shqetësimi, sepse ka shumë raste të tilla, sidomos në spitalin e traumës. A mund të gjejë zgjidhje ky rast me nenin 238/a?

Po, zoti Luli.

Kujtim Luli – Në analizë të dispozitës së cituar, që është neni 235, e gjen zgjidhjen, sepse kjo parashikon qëllimin e posaçëm për ta penguar atë të kryejë detyrën apo shërbimin sipas ligjit. Ky qëllim i posaçëm mbron çdo punonjës në ushtrimin e veprimtarisë së tij edhe në momentin e kryerjes së detyrës. Pra, që kryen një detyrë shtetërore apo shërbim publik, me qëllim që ta pengojë të kryejë detyrën apo shërbimin sipas ligjit. Kështu që kjo dispozitë këtu ka qenë dhe, nëse ata kanë bërë kallëzim penalisht, duhet të kenë marrë zgjidhje në zbatim të kësaj dispozite. Edhe masat e dënimit janë më të ashpra sesa dispozita që parashikua.

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Luli!

Mua më duket se kjo e zbut. Kjo shkon në të kundërt të nenit 235, paragrafi i parë.

Elena Xhixha- Zoti kryetar, unë jo më kot e shtrova diskutimin, sepse, nëse do të ishte mendimi im juridik dhe ligjor, kjo ezaurohej te neni 235 dhe nuk do të ishte e nevojshme ta diskutonim.

Ulsi Manja- Atëherë, ju, si relatore, i qëndron apo e tërheq këtë?

Elena Xhina – Unë e tërheq dhe mendoj se shkrihet te neni 235.

Ulsi Manja – Atëherë, neni 13, i cili ndryshon nenin 238/a, që ka të bëjë me shtimin e një neni të ri “Pengimi i ushtrimit të detyrës së profesionistit shëndetësor” të hiqet. Në fakt, këtë e ezauron shumë mirë neni 235, paragrafi i parë. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14, që flet për prishjen e rendit dhe qetësisë publike.

Elena Xhina – Atëherë, në nenin 14 propozohet që paragrafi të ndryshohet. Ne kemi sjellë një riformulim, pasi kemi menduar që duhet të saktësojmë zonat se kur gjenerohet zhurma. Gjithashtu, kemi shtuar termin “që cenon dukshëm qetësinë në zona të banuara ose në mjedise publike”, kjo në mënyrë që të cilësohet pasoja që vepra sjell.

Gjithashtu, kemi menduar që duhet ta heqim masën e gjobës, sepse formulimi është bërë në tekstin e dispozitës, ndërkohë që Kodi Penal nuk kërkon që gjoba të inkorporohet në trupit e dispozitës, pasi është e përcaktuar në nenin 34 të pjesë së së përgjithshme dhe formulimi i paragrafit është i tillë: “Ushtrimi i veprimtarisë ekonomike që lëshon/gjeneron zhurmë në mjedis, në kundërshtim me ligjin apo në tejkalim të normave të lejuara me ligj, që cenon dukshëm qetësinë në zona të banuara ose mjedise publike dhe kur është marrë më parë masa administrative, dënohet me gjobë, ose me burgim deri në dy vjet”. Pra përsëri është shtuar termi “kur është marrë më parë masë administrative”.

MBYLLET MBLEDHJA

